

MONITORIMI I AKSESIT NË DREJTËSI DHE PERFORMANCA GJYQËSORE PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË

MANUAL TRAJNIMI PËR SHOQËRINË CIVILE

Procesi i Rregullt Gjyqësor

Manual 1

Tiranë, Shtator 2023

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqësori në fokus” i zbatuar nga një konsorcium prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021”.

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e Institutit për Studimet Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.

© Të gjitha të drejtat e botimit i takojnë Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL)

ISBN: 9789928361455

SHKURTIME

GjK	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
GjL	Gjykata e Lartë
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
DNjF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
MD	Ministria e Drejtësisë
KL Gj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
ILD	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
SHM	Shkolla e Magjistraturës
K.Pr.C.	Kodi i Procedurës Civile
K.Pr.P.	Kodi i Procedurës Penale
OJF	Organizata jofitimprurëse
RSh	Republika e Shqipërisë
CEPEJ	Council of Europe European Commission for the Efficiency of Justice
UNROLI	United Nations Rule of Law Indicators
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development
WJP	World Justice Project

Pasqyra e lëndës

SHKURTIME	3
HYRJE.....	9
OBJEKTIVAT DHE REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET	11
STRUKTURIMI DHE PËRMBAJTJA E MODULEVE	12
PLANI I TRAJNIMIT.....	14

MODULI 1

ZHVILLIMI I GJYKIMIT TË DREJTË NË PROCESIN PENAL.....	16
1. E drejta e mbrojtjes	16
2. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti	22
3. Parimi i sigurisë juridike	24
4. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.....	24
5. Parimi i prezumimit të pafajësisë.....	25
6. Parimet e mosdënimit pa ligj dhe ligjit penal favorizues i cili ka fuqiprapavepruese.....	26
7. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes.....	27
<i>Treguesit e realizimit</i>	27
<i>Metoda e matjes</i>	31

MODULI 2

ZHVILLIMI I GJYKIMIT TË DREJTË NË PROCESIN CIVIL DHE ADMINISTRATIV	32
1. E drejta e mbrojtjes	33
2. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti	36
3. Parimi i sigurisë juridike	39
4. Parimi i disponibilitetit.....	41
5. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes.....	43
<i>Treguesit e realizimit</i>	43
<i>Metodat e matjes</i>	45

MODULI 3

GJYKIMI NGA NJË GJYKATË E CAKTUAR ME LIGJ.....	46
1. Kompetenca lëndore dhe tokësore e gjykatës në gjykimin civil dhe administrativ.....	46
2. Juridiksioni i gjykatës në gjykimin civil dhe administrativ	49
3. Përbërja e rregullt e trupit gjykues.....	51
5. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes.....	52
<i>Treguesit e realizimit</i>	52
<i>Metodat e matjes</i>	52

MODULI 4

GJYKIMI NGA NJË GJYKATË E PAVARUR DHE E PAANSHME.....	53
1. Gjykimi nga një gjykatë e pavarur	53
2. Gjykimi nga një gjykatë e paanshme	54
3. Caktimi i trupit gjykues nëpërmjet procedurës së shortit.....	56
4. Shkaqet e heqjes dorë dhe përjashtimit të gjyqtarit në çështjet civile, administrative dhe penale	57
5. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes.....	59
<i>Treguesit e realizimit</i>	59
<i>Metodat e matjes</i>	60

MODULI 5

E DREJTA PËR TË PASUR NJË GJYKIM PUBLIK	61
1. E drejta e publikut për të marrë pjesë në seancat gjyqësore	61
2. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes	63
<i>Treguesit e realizimit</i>	63
<i>Metodat e matjes</i>	64

MODULI 6

MASAT PREVENTIVE PËR MBROJTJEN E PALËVE NË PROCES	65
1. Sigurimi i padisë	65
2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë	67

3. Sigurimi i provës.....	69
4. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes.....	71
<i>Treguesit e realizimit</i>	71
<i>Metodat e matjes</i>	72
RASTE STUDIMORE	73
Kazus nr. 1	73
Kazus nr. 2	74
EKSTRAKTE.....	75
BIBLIOGRAFIA	79

HYRJE

Manuali i Trajnimit mbi “Procesi i Rregullt Gjyqesor” vjen si vijimësi e Guidës së Monitorimit për Shoqërinë Civile “Aksesi në Drejtësi dhe Gjykimi i Drejtë”, synimi i të cilës është aftësimi i aktorëve të shoqërisë civile që të ndërmarrin nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit nëpërmjet:

- Zhvillimit të një kornize të përgjithshme matjeje për të monitoruar përvojën e qytetarëve në plotësimin e nevojave të tyre të përditshme ligjore dhe në aksesin në sistemin e drejtësisë.
- Ofrimit për organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në fushat e sistemit të drejtësisë dhe ndihmës juridike, studentëve të drejtësisë dhe gazetarëve të një kornize të përbashkët referimi, në mënyrë që të nxiten, të përmirësohen dhe të harmonizohen nismat e tyre për të monitoruar aksesin në drejtësi të qytetarëve.

Në vijim të treguesve dhe të faktorëve të përcaktuar në Guidë, nëpërmjet këtij Manuali do të analizohen në mënyrë të detajuar të gjitha elementet dhe standardet që duhet të zbatohen për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke u ndalur në katër komponentë kryesorë:

1. *Zhvillimi i një gjykimi të drejtë*
2. *Gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*
3. *Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj*
4. *E drejta për të pasur një gjykim publik*

Analiza ligjore e akteve ndërkombëtare dhe kuadrit ligjor të brendshëm do të ndërthuren me jurisprudencën e GjEDNj-së dhe jurisprudencën e GjK-së dhe GjL-së, si dhe do të merren në analizë disa vendime të praktikës gjyqësore me qëllim dhënien e një tabloje të plotë të mënyrës së zbatimit dhe respektimit të këtyre parimeve dhe ofrimit të elementeve të referimit për monitorimin e këtyre elementeve nga aktorët e drejtësisë.

Manuali do të ndahet në **6 module**, ku secili modul do të strukturohet në disa aspekte, me qëllim analizimin në mënyrë të detajuar të të gjitha elementeve që përmbajnë katër komponentët e mësipërm:

Moduli i parë do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve kryesore të zhvillimit të gjykimit të drejtë në procesin penal duke u fokusuar tek e drejta e mbrojtjes, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti, parimi i sigurisë juridike, parimi i mosrëndimit të pozitës

së të pandehurit, parimi i prezumimit të pafajësisë, parimet e mosdënimit pa ligj dhe ligjit penal favorizues, i cili ka fuqi prapavepruese.

Moduli i dytë do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve kryesore të zhvillimit të gjyqimit të drejtë në procesin civil dhe administrativ duke u fokusuar tek e drejta e mbrojtjes, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti, parimi i sigurisë juridike dhe parimi i disponibilitetit.

Moduli i tretë do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve kryesore të zhvillimit të gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj duke u fokusuar te kompetenca lëndore dhe tokësore e gjykatës në gjykimin civil dhe administrativ, juridiksioni i gjykatës në gjykimin civil dhe administrativ dhe përbërja e rregullt e trupit gjykues.

Moduli i katërt do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve kryesore të zhvillimit të gjyqimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme duke u fokusuar te gjykimi nga një gjykatë e pavarur, gjykimi nga një gjykatë e paanshme, caktimi i trupit gjykues nëpërmjet procedurës së shortit dhe shkaqet e heqjes dorë e përjashtimit të gjyqtarit në çështjet civile, administrative dhe penale.

Moduli i pestë do të përmbajë një analizë të detajuar të së drejtës për të pasur një gjykim publik, duke u fokusuar te drejta e publikut për të marrë pjesë në seancat gjyqësore.

Moduli i gjashtë do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve kryesore të masave preventive për mbrojtjen e të drejtave të palëve në proces, duke u fokusuar te siguri i padisë, pezullimi i ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe siguri i provës.

Modulet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 do të përmbajnë udhëzime në lidhje me indikatorët dhe mënyrën e realizimit të monitorimit.

OBJEKTIVAT DHE REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET

Ky Manual ka për qëllim aftësimin e aktorëve të shoqërisë civile, të studentëve, të gazetarëve, të praktikantëve të ligjit dhe thellimin e njohurive të tyre mbi parimet dhe standardet e zhvillimit të procesit të rregullt ligjor.

Manuali ka për qëllim:

- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të brendshëm në lidhje me procesin e rregullt ligjor, me fokus zhvillimin e një gjykimi të drejtë dhe publik, nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj;
- Nëpërmjet ndërthurjes së metodës teorike me kazuse dhe ushtrime nga praktika, do të synojë aftësimin dhe rritjen e kapacitetit ligjor të aktorëve të shoqërisë civile, të studentëve, të gazetarëve, të praktikantëve të ligjit për zbatimin dhe monitorimin e këtyre parimeve.

Në përfundim të këtij manuali aktorët e shoqërisë civile do të kenë aftësitë e duhura për të ndërmarrë nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit të sistemit të drejtësisë dhe ndihmës juridike, për monitorimin e respektimit të parashikimeve ligjore të zhvillimit të një gjykimi të drejtë dhe publik, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe e caktuar me ligj.

STRUKTURIMI DHE PËRMBAJTJA E MODULEVE

MODULI 1	<p>ZHVILLIMI I GJYKIMIT TË DREJTË NË PROCESIN PENAL</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E drejta e mbrojtjes 2. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti 3. Parimi i sigurisë juridike 4. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit 5. Parimi i prezumimit të pafajësisë 6. Parimet e mosdënimit pa ligj dhe ligjit penal favorizues i cili ka fuqi prapavepruese 7. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes
MODULI 2	<p>ZHVILLIMI I GJYKIMIT TË DREJTË NË PROCESIN CIVIL DHE ADMINISTRATIV</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E drejta e mbrojtjes 2. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti 3. Parimi i sigurisë juridike 4. Parimi i disponibilitetit 5. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes
MODULI 3	<p>GJYKIMI NGA NJË GJYKATË E CAKTUAR ME LIGJ</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca lëndore dhe tokësore e gjykatës në gjykimin civil dhe administrativ 2. Juridiksioni i gjykatës në gjykimin civil dhe administrativ 3. Përbërja e rregullt e trupit gjykues 4. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes
MODULI 4	<p>GJYKIMI NGA NJË GJYKATË E PAVARUR DHE E PAANSHME</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjykimi nga një gjykatë e pavarur 2. Gjykimi nga një gjykatë e paanshme 3. Caktimi i trupit gjykues nëpërmjet procedurës së shortit 4. Shkaqet e heqjes dorë dhe përjashtimit të gjyqtarit në çështjet civile, administrative dhe penale 5. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes

MODULI 5	E DREJTA PËR TË PASUR NJË GJYKIM PUBLIK <ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesëmarrja e publikut në seancat gjyqësore 2. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes
MODULI 6	MASAT PREVENTIVE PËR MBROJTJEN E PALËVE NË PROCES <ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurimi i padisë 2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë 3. Sigurimi i provës 4. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes

PLANI I TRAJNIMIT

Prezantimi i manualit sipas moduleve të strukturuar si më lart mund të realizohet në një kohëzgjatje 3 orë, sipas tabelës së mëposhtme:

Aktiviteti	Metoda	Kohëzgjatja
<p>Zhvillimi i gjykimit të drejtë në procesin penal, civil dhe administrativ (Moduli 1 - 2)</p> <p>Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me aktet ndërkombëtare dhe ligjet e brendshme që parashikojnë standardet për elementet e gjykimit të drejtë në çështjet penale, civile dhe administrative, duke e ndërthurur me vendimet gjyqësore të gjykatave në RSh dhe GjEDNj</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve studimore</p>	<p>2 orë</p>
<p>Gjykimi nga një gjykatë e krijuar me ligj dhe nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme (Moduli 3-4)</p> <p>Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me aktet ndërkombëtare dhe ligjet e brendshme që parashikojnë standardet për elementet e gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj dhe nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme në çështjet penale, civile dhe administrative, duke e ndërthurur me vendimet gjyqësore të gjykatave në RSh dhe GjEDNj</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve studimore</p>	<p>30 minuta</p>

<p>E drejta për të pasur një gjykim publik dhe masat preventive për mbrojtjen e të drejtave të palëve në proces</p> <p>(Moduli 5-6)</p> <p>Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me aktet ndërkombëtare dhe ligjet e brendshme që parashikojnë standardet për elementet e të drejtës për të pasur një gjykim publik në çështjet penale, civile dhe administrative, duke e ndërthurur me vendimet gjyqësore të gjykatave në RSh dhe GjEDNj.</p> <p>Gjithashtu, nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me masat preventive për mbrojtjen e të drejtave të palëve në proces të parashikuar në legjislacionin shqiptar dhe praktikën e gjykatave në RSh lidhur me zbatimin e këtyre masave.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve studimore</p>	<p>30 minuta</p>
--	---	------------------

MODULI 1

ZHVILLIMI I GJYKIMIT TË DREJTË NË PROCESIN PENAL

Procesi i rregullt ligjor është një garanci jetike për të gjitha llojet e proceseve në një shoqëri demokratike, por procedimet penale për nga elementet e tyre komplekse janë më të lehta për të qenë cenuese të të drejtave dhe më të vështira për të arritur garancitë ligjore e kushtetuese.

Gjykimi i drejtë në procesin penal ka si kuadër ligjor rregullator Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, K.Pr.P. dhe KEDNj. Aspektet e tjera jurisprudenciale përbëhen nga një praktikë e mirëkonsoliduar e GjL-së, GjK-së dhe GjEDNj-së. Shumica e çështjeve të GjEDNj-së lidhen në mënyrë të ngutshme shkeljet e nenit 6 të KEDNj-së dhe shqetësimi kryesor i GjEDNj-së në këto raste ka qenë të vlerësojë drejtësinë e përgjithshme të procedimit penal. Pajtueshmëria me kërkesat e një gjykimi të drejtë duhet të shqyrtohet në çdo rast duke pasur parasysh zhvillimin e procesit në tërësi dhe jo në bazë të një shqyrtimi të izoluar të një aspekti të veçantë ose të një incidenti të veçantë.¹

1. E drejta e mbrojtjes

Në procedimin penal “mbrojtja” është një e drejtë e pashmangshme dhe e pamohueshme e garantuar nga Kushtetuta² që do të thotë se askujt nuk mund t’i krijohen pengesa për të mbrojtur të drejtat e tij dhe/ose interesat e ligjshme duke krijuar rezistencë nëpërmjet kundërshtimit në procedimin penal. Parashikimi i mbrojtjes së të hetuarit/pandehurit si një e drejtë, e klasifikon atë si një fakultet dhe jo si një detyrim i varur në vullnetin e vetë të hetuarit/pandehurit. Ndërsa në funksion të një procedimi të drejtë që në shënjestër ka arritjen e drejtësisë penale nëpërmjet zbatimit të normave ligjore, parashikohet nga ligji dhe “mbrojtja e detyrueshme”, e pavarur nga vullneti i të pandehurit.³

E drejta për t’u mbrojtur nga një mbrojtës profesionist/avokat është kuptuar si përbërëse e së drejtës së mbrojtjes që mban vetë titullari i saj, i pandehuri, si dhe viktimi nga vepra penale. Për personin nën hetim ajo fillon të ushtrohet që nga momenti i zbatimit të masës së sigurimit,⁴ i arrestimit apo ndalimit,⁵ apo që nga momenti i marrjes dijeni nga ana e personit

1. Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights, Right to a fair trial, Gusht 2022, fq. 7, aksesuar në linkun: https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/guide_art_6_criminal_eng.

2. Neni 31, pika ç, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

3. Dhimitër Lara, “Koment mbi procedurën penale”, 2019, fq. 105.

4. Neni 246 K.Pr. P.

5. Neni 255 K.Pr. P.

nën hetim se ndaj tij po zhvillohen hetime, kur nga prokurori kryhen veprime në të cilat i hetuari ka të drejtën që të marrë pjesë.⁶

Në vazhdimësi të procedimit mbrojtësi ka një pozicion barazie përkundrejt prokurorit, në mbrojtje të plotë të të drejtave dhe interesave ligjore të personit nën hetim apo të pandehurit. Mbrojtësi mund të jetë i zgjedhur nga vetë personi nën hetim apo familjarët e tij ose i caktuar nga organi që vepron në fazën që ai caktohet. Po ashtu janë përshtatur dy pozicione të mbrojtësit: ai i mbrojtësit-asistues, që konsiston në praninë e njëkohshme të mbrojtësit person fizik me atë të të pandehurit/personit në hetim person fizik dhe pozicioni i mbrojtësit-përfaqësues që konsiston në praninë e mbrojtësit person fizik pa praninë e të pandehurit/personit nën hetim person fizik. Diferenca në këto dy pozicione të mbrojtësit shfaqet në atë që mbrojtësi asistues është një fakultet, ndërsa mbrojtësi përfaqësues është një detyrim⁷.

Garantimi i pjesëmarrjes së të akuzuarit ose mbrojtësit të tij në proces, në funksion të respektimit të kërkesave të mësipërme, vlen padyshim jo vetëm në shkallën e parë, por edhe në shqyrtimin e çështjes në shkallët e tjera të gjyqimit, veçanërisht në rastet kur në këto gjykime parashikohet edhe zhvillimi i debatit me gojë⁸. Ekzistenca e mbrojtjes është një tregues esencial i një procesi të rregullt penal. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësve në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve⁹. E drejta e gjithkujt të akuzuar penalisht për të qenë efektivisht i mbrojtur nga një avokat, kur është e nevojshme edhe i caktuar kryesisht, është një nga tiparet themelore të një gjykimi të drejtë. Mungesa e një mbrojtjeje efektive në procesin penal ka lidhje të drejtpërdrejtë me realizimin e parimit të kontradiktorialitetit si mjet efikas për zbulimin e së vërtetës, duke disponuar cilësisht edhe mjetet e barabarta¹⁰.

Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit, kujdestarit ligjor ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon. Organi procedues mund të kryejë veprime dhe të përpilojë akte, për të cilat kërkohet pjesëmarrja e të miturit, pa praninë e personave të treguar më sipër, vetëm kur një gjë e tillë është në interes të të miturit ose kur vonesa mund të dëmtojë rëndë procedimin, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit¹¹.

I pandehuri ka të drejtë të zgjedhë jo më shumë se dy mbrojtës. Zgjedhja bëhet me deklaram para organit procedues ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomande. Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa

6. Nenet 199, 204 K.Pr.P.

7. Dhimitër Lara, "Koment mbi procedurën penale", 2019, fq. 107.

8. Vendimi GjEDNj-së Alimena kundër Italisë, datë 19.02.1991. Vendimi nr.19/2003 i GjK-së.

9. Vendimi nr. 5/2003 i GjK-së.

10. Vendimi nr. 33/2003 i GjK-së.

11. Neni 35 i K.Pr.P.

ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij.¹²

Organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur:

- a) është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç;
- b) nuk dëgjon dhe nuk flet;
- c) është me aftësi të kufizuara, që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes;
- ç) është akuzuar për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënim në maksimum jo më pak se 15 vjet me burgim;
- d) akuzohet për një vepër penale, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të K.Pr.P;
- dh) është deklaruar i ikur ose në mungesë, me vendim gjykate;
- e) merret në pyetje personi i arrestuar ose i ndaluar;
- ë) në rastet e parashikuara nga paragrafi 5, i nenit 205, ose paragrafi 1, i nenit 296, të K.Pr.P;
- f) në çdo rast tjetër të parashikuar nga ligji.

Nëse ekzistojnë arsyet për mbrojtje të detyrueshme, organi procedues i cakton menjëherë një mbrojtës të pandehurit. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin në të gjitha fazat e procedimit, për aq kohë sa ekzistojnë kushtet e parashikuara më sipër.

Gjykata, prokurori dhe policia gjyqësore, kur duhet të kryejnë një veprim për të cilin parashikohet ndihma e mbrojtësit dhe kur i pandehuri është pa mbrojtës, njoftojnë për këtë veprim mbrojtësin e caktuar. Mbrojtësi i caktuar mund të zëvendësohet vetëm për shkaqe të përligjura. Ai i pushon funksionet kur i pandehuri zgjedh mbrojtësin e tij¹³.

Kur nuk janë rastet e mbrojtjes së detyrueshme dhe i pandehuri që nuk ka mjete financiare të mjaftueshme kërkon mbrojtës, organi procedues cakton mbrojtësin nga lista e vënë në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas. Shpenzimet e mbrojtjes mbulohen nga shteti¹⁴.

Një aspekt i rëndësishëm i të drejtës së mbrojtjes, lidhet me verifikimin e paraqitjes së palëve para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor. Kryetari i trupit gjykues kontrollon paraqitjen e palëve dhe në rast se palët nuk janë paraqitur, kryetari verifikon nëse njoftimet janë të rregullta dhe nëse mungesa është e justifikuar. Kur mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk është i pranishëm,

12. Neni 48 i K.Pr.P.

13. Neni 49 i K.Pr.P.

14. Neni 49/a i K.Pr.P.

gjykata mund të caktojë si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.

Kur rezulton që i pandehuri ose personi ndaj të cilit është bërë kërkesë për gjykim nga viktima akuzuese nuk ka marrë njoftim ose njoftimi është i dyshimtë, gjykata urdhëron, edhe kryesisht, që të përsëritet thirrja për gjykim.

Kur i pandehuri, qoftë edhe i paraburgosur, ose personi ndaj të cilit ka bërë kërkesë për gjykim viktima akuzuese, nuk paraqitet në seancë dhe del se mungesa është shkaktuar nga forca madhore ose ndonjë pengesë tjetër që e përjashton nga përgjegjësia, gjykata, edhe kryesisht, shtyn ose pezullon shqyrtimin gjyqësor, cakton datën e seancës së re dhe urdhëron që të përsëritet thirrja. Gjykata vendos si më sipër, edhe kur mbrojtësi mungon dhe mungesa është shkaktuar nga forca madhore, përveçse kur i pandehuri kërkon që të procedohet në mungesë të mbrojtësit dhe prania e tij nuk është e detyrueshme. Kur i pandehuri ndihmohet nga dy mbrojtës dhe pengesa për t'u paraqitur lidhet vetëm me njërin prej tyre, thirrja konsiderohet e vlefshme dhe gjykimi zhvillohet me praninë e njërit mbrojtës. Kur del që njoftimi nuk ka qenë i rregullt, gjykata vendos shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor dhe urdhëron përsëritjen e njoftimit¹⁵.

Në rast se as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë.¹⁶

Një aspekt tjetër i respektimit të së drejtës së mbrojtjes, është detyrimi i sekretarisë që ka dhënë vendimin që akti i ankimit t'u njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private.¹⁷ Nëse prokuroria paraqet ankim ndaj vendimit të gjykatës, kopja e këtij ankimi duhet t'i dërgohet të pandehurit sipas mënyrave dhe në vendet e parashikuara nga nenet 140 e vijues të K.Pr.P. Duke mos u përmbushur ky detyrim ligjor, të pandehurit nuk i jepet mundësia që të dijë se çështja e tij do të shqyrtohet nga gjykata më e lartë dhe njëkohësisht të dëgjohet e të mbrohet, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, rreth parashtrimeve të bëra nga prokurori në ankimin e tij. Mohimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, përbën shkelje me karakter kushtetues, të cilat e bëjnë procesin ligjor jo të rregullt, në kuptim të nenit 42 pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë¹⁸.

Përfaqësimi me avokat në GjL, synon garantimin e një mbrojtjeje sa më efektive dhe sa më profesionale të të drejtave dhe lirive themelore të individit. Jurisprudenca jonë kushtetuese, në respektim edhe të qëndrimeve të mbajtura nga GjEDNj, ka konkluduar se trajtimi nga GjL vetëm i problemeve ligjore, jo vetëm që justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat, por për më tepër është i domosdoshëm për garantimin e një mbrojtjeje efektive dhe të dobishme,

15. Nenet 348-350 të K.Pr.P.

16. Çështja "T" kundër "T", marrë nga Komentari i KEDNj Frowin/Puekert.

17. Neni 414 i K.Pr.P.

18. Vendimi nr.44/2000 i GjK-së.

gjithnjë në favor të të pandehurit. Në çështjen “Pakëll kundër Gjermanisë”, GjEDNj vë në dukje, ndër të tjera, se nisur nga natyra e gjykimit në GjL dhe fokusimin e saj në çështje të ligjit, “pa ndihmën e një avokati, procesi nuk mund të kontribuonte në mënyrë të dobishme në shqyrtimin e çështjeve juridike që qëndronin në thelb të mosmarrëveshjeve”.¹⁹

Situata juridike, kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëlojtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Prania personale e të pandehurit në seancën gjyqësore për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i tij nuk është e domosdoshme, nëse objekt shqyrtimi janë trajtimet dhe përfundimet juridike të arritura nga gjykata më e ulët, vendimi i së cilës nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit.²⁰ Në këto raste, GjL nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj. Ndryshe paraqitet situata, kur si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi të zhvillohet pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. GjL, kur gjykon në këtë rast, me përjashtim të argumenteve të paraqitura nga prokurori nuk ka mundësi të administrojë asnjë argument ligjor nga pala e akuzuar. Kur çështja shqyrtohet mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, i cili kërkon rëndimin e pozitës së të pandehurit dhe faktit, që as i pandehuri dhe as avokati nuk ishin të pranishëm në gjykim, GjL nuk duhet ta zhvillojë gjykimin pa u garantuar për arsyet e mosparaqitjes së tyre dhe pa i dhënë mundësi palës së akuzuar për të realizuar mbrojtjen ligjore. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, është e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejohet zhvillimi i seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, pasi kjo është e vetmja mënyrë që i pandehuri përmes figurës përfaqësuese të avokatit të marrë pjesë në debatet e mundshme²¹.

Në rastin e të pandehurit i cili është gjykuar në mungesë, duhen pasur parasysh disa standarde:

- a) i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në procesin gjyqësor të kryer në ngarkim të tij;
- b) i pandehuri mund të heqë dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejte;
- c) i pandehuri duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e një procesi gjyqësor në ngarkim të tij;

ç) duhet të ekzistojnë instrumente paraprake ose riparuese për të shmangur procese në ngarkim të të pandehurit, ose për të siguruar një proces të ri dhe, nëpërmjet depozitimit të provave të reja, të drejtën e mbrojtjes që nuk ka qenë e mundur të ushtrohet personalisht në procesin e zhvilluar në mungesë, të përfunduar tashmë.

19. Vendimi nr. 25/2003 i GjK-së.

20. Froëein/Peukert, Europäische Menschenrechtskonvention-Komentar (1996), faqe 227.

21. Vendim nr. 23/2005 i GjK-së; Vendim nr.24/2005 i GjK; Vendim nr. 7/2007 i GjK-së; Vendim nr. 16/2009 i GjK-së.

Autoritetet shtetërore përkatëse kanë për detyrë që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas GjK-së, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin.

Mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit duhet të pranohet vetëm nëse provohet se ata po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse ata nuk kanë kontakte me të pandehurin, çka është detyrë e organeve kompetente shtetërore. Në këtë mënyrë është rigoroz zbatimi i procedurave të njoftimit.

Si konkluzion, në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet të ketë dijeni nëse ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar, duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij²².

Për sa i përket jurisprudencës së GjEDNj-së dhe baza që ajo ka hedhur për këtë trajtim, si më e rëndësishme konsiderohet të jetë çështja F.C.B kundër Italisë ku një gjykatë italiane e riktheu çështjen për gjykim në mungesë të kërkuesit megjithëse ishte informuar nga këshilltari i tij ligjor se ai mbahej në paraburgim jashtë shtetit. GjEDNj deklaroi se kërkuesi nuk kishte shprehur dëshirën për të hequr dorë nga pjesëmarrja dhe nuk pranoi argumentin e paraqitur nga Qeveria se ai kishte përdorur qëllimisht taktika vonese për të mos u dhënë autoriteteve italiane adresën e tij. Autoritetet italiane ishin në dijeni të faktit se kërkuesi u ishte nënshtruar procedimeve jashtë shtetit dhe mund të ishte në pajtim me kujdesin e kërkuar për të siguruar të drejtat e mbrojtjes që të ishin ushtruar efektivisht për të vazhduar gjyqin pa ndërmarrë hapa të tjerë për të qartësuar pozicionin e kërkuesit.

Ndërkohë në çështjen e Kremzou kundër Austrisë²³ kërkuesi ishte përjashtuar nga një seancë bazuar në ligj dhe GjEDNj konstatoi se prania e tij nuk kërkohet në bazë të Nenit 6 (1) ose 6 (3) c duke qenë se avokati i tij ishte në gjendje të ndiqte gjyqin dhe të fliste në emër të tij. Megjithatë, GjEDNj konstatoi shkelje kur kërkuesi u përjashtua nga seanca e apelit mbi dënimin, që përfshinte rritje të dënimit me burgim të përjetshëm dhe vendosjen në një burg të veçantë duke u nisur nga motivimi i krimit për të cilin juria nuk kishte mundur të përcaktonte qartë. GjEDNj u shpreh se meqë vlerësimi i karakterit të kërkuesit, gjendja e tij

22. Vendim nr. 30/2010 i GjK-së. Vendim nr. 45/2011 i GjK-së.

23. Vendimi GjEDNj-së Kremzow kundër Austrisë, 21 shtator 1993.

mendore dhe motivimi ishin të rëndësishëm për procesin gjyqësor dhe kërkuesi rrezikonte mjaftueshëm, ai duhet të ishte në gjendje të ishte i pranishëm dhe të merrte pjesë ashtu si dhe avokati i tij.

2. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti

Kërkesat për “barazinë formale” janë të kuptuara në forma, si barazi përpara ligjit dhe si barazi në ligj. Barazia përpara ligjit do të thotë se asnjë palë nuk mund të qëndrojë dhe nuk mund të përcaktohet përmbi ligjin. Barazia në ligj kuptohet me ndalimin që i bëhet ligjvënësit që të miratojë ligje që kanë në thelb diskriminimin me referim të gjinisë, racës, etnisë, gjuhës, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale etj. Nga ana tjetër, barazia thelbësore si e ndryshme nga ajo formale ka të bëjë me vendosjen që në fillim të të gjithëve mbi një bazë të barabartë për ushtrimin e të drejtave të tyre që gjen përputhje me objektivat e një rendi thellësisht social. Në drejtësinë penale bëhen përpjekje që koncepti i barazisë të shtrihet jo vetëm ndërmjet palëve private, por edhe ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit. Por duke pasur parasysh ndryshimin e vetë natyrës, cilësisë dhe qëllimit që konkretisht kanë dhe që kërkojnë të arrijnë, kjo barazi duhet të kuptohet si barazi armësh, por jo si “njëllojshmëri armësh”. Po ashtu, duke pasur parasysh emërtimin e subjekteve si palë, cilësi që fitohet vetëm gjatë gjykimit dhe jo gjatë fazës së hetimeve paraprake, për barazi të armëve mund të flitet vetëm përgjatë gjykimit, duke përjashtuar kështu fazën e parë të procesit, atë të hetimeve paraprake²⁴.

Për vetë natyrën e tyre, barazia e armëve dhe e shanseve dhe, për rrjedhojë, vetë parimi i kontradiktoritetit, luajnë rol tepër të rëndësishëm sidomos në procesin penal, sepse në këtë rast, përballë personit të akuzuar për kryerjen e një vepre penale, normalisht është vetë shteti. Pikërisht për këtë arsye, shteti duhet të ndërmarrë të gjitha masat ligjore për t’i siguruar atij ose përfaqësuesit të tij pjesëmarrjen në proces dhe përmes saj edhe mundësinë e njohjes dhe deklarimit për të gjitha faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që i referohen akuzës së bërë. Garantimi i pjesëmarrjes së të akuzuarit ose mbrojtësit të tij në proces, në funksion të respektimit të kërkesave të mësipërme, vlen padyshim jo vetëm në shkallën e parë, por edhe në shqyrtimin e çështjes në shkallët e tjera të gjykimit, veçanërisht në rastet kur në këto gjykime parashikohet edhe zhvillimi i debatit me gojë²⁵.

Ekzistenca e mbrojtjes është tregues esencial i një procesi të rregullt penal. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësve në gjykim, por dhe t’i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve.²⁶ E drejta e gjithkujt të akuzuar penalisht për të qenë efektivisht i mbrojtur nga një avokat, kur është e nevojshme edhe i caktuar kryesisht, është një nga tiparet themelore të një gjykimi të drejtë. Mungesa e një mbrojtjeje efektive në procesin penal ka lidhje të drejtpërdrejtë me realizimin e parimit të

24. Dhimitër Lara, “Koment mbi procedurën penale”, 2019, fq. 31.

25. Vendim i GjEDNj-së Alimena kundër Italisë datë 19/02/1991. Vendim nr.19/2003 i GJK-së.

26. Vendim nr.5/2003 i GJK-së.

kontradiktorialitetit si mjet efikas për zbulimin e së vërtetës, duke disponuar cilësisht edhe mjetet e barabarta²⁷.

Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata, me objektivitet e paanësi²⁸.

Në këtë mënyrë, i pandehuri gjatë procesit penal duhet të informohet nga organi procedues për të drejtën e deklarimeve në çdo fazë të hetimit, duke i dhënë mundësi për të shprehur qëndrimet e tij, krijimi i mundësisë së pyetjes së ekspertëve, paraqitja e shpjegimeve dhe e prapësimeve, paraqitja e provave, njohja e mbrojtjes me provat e paraqitura nga prokurori në mënyrë që të ketë mundësi më pas të bëjë kundërshtimet, etj.

Në rastin e paraqitjes së pretendimeve për shkeljen e parimit të kontradiktoritetit, duhen shqyrtuar rast pas rasti rrethanat e çështjes, si për shembull veprimet që ka ndërmarrë mbrojtësi (nëse ka marrë pjesë në fazën e hetimeve paraprake, ka qenë i pranishëm në seancat gjyqësore, ka paraqitur parashtrime me shkrim, ka pyetur dëshmitarë, ka kërkuar marrjen e provave etj), fakti se në cilën fazë të procesit ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe sa e rëndësishme ishte ajo për të pandehurin dhe rezultatin e gjithë procesit gjyqësor, fakti nëse gjykatat mund të kishin marrë masa për të parandaluar shkeljen në fjalë, fakti nëse shkeljet e pretenduara u ngritën para gjykatës etj²⁹.

Një element thelbësor i respektimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve është zhvillimi i gjykimit të shkurtuar dhe ndalimi i ndryshimit të cilësimit juridik të akuzës penale.

Informimi i plotë dhe i saktë për akuzat e ngritura, si dhe për kualifikimin juridik të veprës penale, duhet të konsiderohet si kusht themelor për besueshmërinë e procesit dhe për përgatitjen e duhur të një mbrojtjeje efektive, e cila është një nga garancitë themelore për realizimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNj-së.

Nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm edhe në rastin kur procedohet me gjykim të shkurtuar, njësoj si në gjykimin e zakonshëm, do të mund të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe të dënojnë të pandehurin me një masë dënimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, instituti do të humbiste çfarëdolloj justifikimi kushtetues, për arsye se i pandehuri, duke hequr dorë në mënyrë të vullnetshme nga disa parime kushtetuese si parimi i barazisë së armëve dhe nga parimi i kontradiktoritetit, do të sakrifikonte të drejtat e tij kushtetuese jo vetëm pa pasur asnjë lloj përfitimi, por edhe duke marrë një dënim më të lartë nga ai që priste.

Nga sa më lart, kur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm procedohet me gjykim të

27. Vendim nr.33/2003 i GjK-së.

28. Vendim nr.19/2003 i GjK-së. Vendim nr. 19/2008 i GjK-së.

29. Vendim nr. 40/2011 i GjK-së.

shkurtuar, procedim në të cilin, duke qenë se gjykata merr në konsideratë vetëm dosjen e prokurorit, nuk ekziston mundësia e realizimit të së drejtës së mbrojtjes efektive nga i pandehuri, ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga ana e gjykatës, është në kundërshtim me qëllimin e këtij gjykimi³⁰.

3. Parimi i sigurisë juridike

Parimi i sigurisë juridike në çështjet penale materializohet në ndalimin e gjykimit më shumë se njëherë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*). Parimi *ne bis in idem* është një instrument kryesor juridik, një garanci thelbësore e individit, e përfshirë në dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut³¹, që rregullon marrëdhëniet në fushën penale të brendshme dhe ndërkombëtare. Ky parim nënkupton se asnjë individ nuk mund të gjykohet apo dënohet përsëri për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është shpallur i pafajshëm ose është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme. Kriteri “e njëjta vepër” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar³². Duke u nisur nga interpretimet e mësipërme rezulton se ky parim nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur të dyja veprat penale nuk kanë elemente të njëjta. Nëse gjenden elemente të njëjta parimi “*ne bis in idem*” ndalon çdo dënim tjetër apo procedim të mëtejshëm.³³ *Res judicata* nënkupton, në aspektin formal e procedural, mosankueshmërinë e vendimit, ndërsa, në atë substancial, fuqinë e detyrueshme të vendimit³⁴.

Neni 7 i K.Pr.P. ka burim kushtetues atë të nenit 34 dhe të zbatuar e krijuar më mirë teknikisht. Fillimisht, norma kushtetuese parashikon “mos dënim” a “mos gjykim” dy herë për të njëjtën vepër penale, pa kërkuar karakterin e formës së prerë të vendimit të dënimit apo të vendimit rezultat i gjykimit. Kjo do të thotë se në vështrim kushtetues është gjykimi në shkallë të parë funksioni i parë dhe i vetëm gjyqësor i pashmangshëm për shkak të ushtrimit të ndjekjes penale dhe dënimi është rrjedhojë e tij. Të njëjtën forcëpenguese të vendimit të formës së prerë, por tashmë shprehimisht të deklaruar e parashikon ligji procedural në nenin 7. Si rregull i përgjithshëm, përveç aftësisë të ekzekutimit, forma e prerë ka aftësinë ndaluese të përsëritjes së një procesi dhe dhënies së një dënimi për herë të dytë, mbi të njëjtën gjë të gjykuar. Kjo gjë paraqitet si një parashikim garantues gjyqësor në favor të të gjykuarit³⁵.

4. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit

Pozita e të pandehurit nuk mund të rëndohet nga gjykata që shqyrton ankimin e tij. Ky është një rregull që në doktrinë dhe në jurisprudencë njihet si parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformatio in peius-lat*). Mosrëndimi i pozitës së të pandehurit përmendet

30. Vendim nr. 4/2012 i GjK-së.

31. Shih nenin 4, Protokollin VII i KEDNj-së; nenin 14, § 7 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; nenin 50 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

32. Vendim nr. 33/2011 i GjK-së. Vendim nr. 5/2005 i GjK-së.

33. Vendim nr.5/2005 i GjK-së.

34. Vendim nr. 29/2006 i GjK-së; Vendim nr. 47/2011 i GjK-së.

35. Dhimitër Lara, “Koment mbi procedurën penale”, 2019, ff. 111-112.

shprehimisht në legjislacionin tonë procedural penal dhe konkretisht në nenin 425 pika 3. Sipas këtij rregullimi ligjor, gjykata nuk mund:

- të caktojë një dënim më të rëndë,
- të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë,
- t'i japë pafajësinë për një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar
- t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë.

Në K.Pr.P. ka edhe një dispozitë tjetër, konkretisht neni 244 pika 3 që nuk e lejon gjykatën që të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori.

Megjithëse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe KEDNj nuk e përmendin në mënyrë të shprehur këtë parim, ai në vetvete e përmban dimensionin kushtetues. Zbatimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit është një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës më të lartë merr rëndësi në një shoqëri demokratike, prandaj askush nuk mund ta humbasë këtë përparësi. Ekzistenca e këtij parimi i jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta, vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Parë nga ky këndvështrim, mosrespektimi i *reformatio in peius* do të përbënte njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së³⁶.

5. Parimi i prezumimit të pafajësisë

Prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor në demokracitë moderne, monarkitë kushtetuese dhe republikat, të cilat e kanë përfshirë në mënyrë të qartë atë në Kushtetutë dhe në ligjet e tyre.

Parimi i prezumimit të pafajësisë është parashikuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 10 dhjetor 1948, si dhe në Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe Politike, të miratuar në vitin 1966³⁷ e cila është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datën 04.09.19991.

Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është *indubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit,

36. Vendim nr.13/2003 i GJK-së; Vendim nr. 15/2008 i GJK-së.

37. Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar në vitin 1966, neni 14/2.

se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza³⁸. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe GJEDNj.³⁹ Prezumimi i pafajësisë është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor që parashikohet në nenin 6 par. 2 të KEDNj-së. Ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individit të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal, mjafton që të ketë një arsyetim i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor⁴⁰.

Në zbatim të këtij parimi, organi i akuzës duhet të arrijë të provojë fajësinë e të pandehurit, për veprën penale për të cilën ai akuzohet. Nga ana tjetër, gjykata duhet të kryejë një hetim gjyqësor të gjithanshëm, duke analizuar çdo provë dhe duke respektuar kontradiktoritetin dhe barazinë e armëve, për të arritur në konkluzionin se i pandehuri është fajtor për veprën për të cilën ai është akuzuar⁴¹.

Ekzistojnë mendime se nuk është e drejtë që të pandehurit t'i njihen kaq shumë të drejta me arsyetimin se shoqëria nuk duhet t'u japë të drejta kriminelëve të cilët me sjelljet e tyre u kanë sjellë dëme komunitetit. Por ky është një mendim që nuk mund të përkrahet pasi në favor të të pandehurit është sanksionuar parimi i prezumimit të pafajësisë i cili shërben si garanci dhe ofron një mbrojtje të sigurt të lirisë personale (Habeas Corpus).⁴²

6. Parimet e mosdënimit pa ligj dhe ligjit penal favorizues i cili ka fuqiprapavepruese

E drejta e shtetasve për të mos u dënuar pa ligj, sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës dhe në nenin 7 të KEDNj-së, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar⁴³.

Garancia e nenit 7 të KEDNj-së mishëron një parim të përgjithshëm sipas të cilit, çdo veprë penale duhet të parashikohet me ligj dhe individit duhet të jetë objektivisht në gjendje të kuptojë përmbajtjen e normës penale dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimeve gjyqësore të saj, se çfarë veprimesh apo mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute. Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe, për këtë arsye, një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm⁴⁴.

Sipas nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese (*lex retro agit in mitius ose lex mitior retro agit*). Parimi i përgjithshëm që vepron në

38. Vendim nr. 23/2009 i GjK-së; Vendim nr. 9/2004 i GjK-së; Vendim nr. 47/2011 i GjK-së.

39. Vendimet e GJEDNj-së, Minelli kundër Zvicrës 25/03/1983, Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar 08/02/1966.

40. Vendim i GJEDNj-së Allenet de Ribemont kundër Francës, datë 10/02/1995.

41. Vendim nr. 00-2022 - 1600/2022 i GjL-së.

42. Kreshnik Myftari, Sevada Guço, "Prezumimi i pafajësisë-parim i rëndësishëm kushtetues", Revista "Studime Juridike" nr. 2, 2013, fq.176.

43. Vendim nr.14/2007 i GjK-së.

44. Vendim i GJEDNj-së Veeber kundër Estonisë, datë 21/01/2003; Vendimi nr. 16/2009 i GjK-së.

sistemin e së drejtës është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Përjashtimi që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal që favorizon pozitën e të pandehurit, synon t'i përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë e të përshtatshme vlerësimeve të ligjvënësit mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve apo mosveprimeve të caktuara, si dhe të subjekteve që i kanë kryer apo mund t'i kryejnë ato në të ardhmen⁴⁵. Është e drejtë sovrane e ligjvënësit që në një moment të caktuar, në përputhje me kushtet ekonomike dhe shoqërore të vendit, politikën penale apo detyrimet ndërkombëtare, të vlerësojë si të nevojshme ndryshimin e ligjit penal, duke mos dënuar ose dënuar me masa më të buta veprime apo mosveprime të caktuara që kryhen brenda territorit të tij. Dhe nëse një vlerësim i tillë është bërë tashmë nga ligjvënësi, është detyrë e organeve shtetërore (gjykatave) për ta zbatuar ligjin e ri në jetën e përditshme, menjëherë dhe sa më mirë, duke pasur parasysh parimin se “... *ligji më i butë duhet të zbatohet nga gjykatat kombëtare si për sa i përket përcaktimit të veprës penale, ashtu edhe sanksioneve të parashikuara prej saj*...”⁴⁶

Një gjë e tillë diktohet para së gjithash për shkak të domosdoshmërisë së garantimit të stabilitetit dhe të sigurisë së marrëdhënieve juridike që vendosen ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës. Në rastin e ligjit penal, i cili si rregull kufizon lirinë individuale, është më se e nevojshme që çdo qytetar, të dijë paraprakisht kufijtë e lirisë së tij si dhe sanksionet që mund t'i vijnë për shkak të kapërcimit të këtyre kufijve. Ai nuk duhet të ndiejë për asnjë çast rrezikun që një ligj i ri penal që mund të parashikojë si të dënueshëm një veprim apo mosveprim të caktuar ose që mund të rëndojë pozitën e tij si i pandehur, do të ketë në të ardhmen fuqi prapavepruese⁴⁷.

7. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes.

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A është njoftuar i pandehuri ose personi nën hetim në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose personit nën hetim të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose personit nën hetim të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij?	
A janë dhënë deklaratimet e nënshkruara nën efektin e kërcënimeve apo torturës?	
A është pyetur i akuzuari me cilësinë e të pandehurit?	

45. Vendim nr.35/2005 i GJK-së; Vendim nr. 14/2007 i GJK-së.

46. Vendim i GjEDNj-së kundër Francës, datë 27/09/1995.

47. Vendim nr. 35/2005 i GJK-së.

A janë dhënë deklaratimet në prani të mbrojtësit dhe janë nënshkruar rregullisht procesverbalet?	
A ka qenë gjykata në kushtet për të vendosur që të lexohen aktet e marra gjatë hetimeve paraprake, sepse për shkak të rrethanave të paparashikuara ato nuk mund të përsëriteshin më?	
A është respektuar fakti që nuk janë të detyruar të dëshmojnë gjinia ose krushqia e afërt e të pandehurit, bashkëshorti për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore, bashkëshorti i ndarë nga i pandehuri për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore, ai që edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit, bashkëjeton ose ka bashkëjetuar me të dhe ai që është i lidhur me të pandehurin me marrëdhënie birësimi?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose personit nën hetim të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të K.Pr.P. dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose personit nën hetim të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose personit nën hetim të këtë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose personit nën hetim të njihet me materialet e çështjes?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose personit nën hetim të paraqesë prova që i shërbejnë mbrojtjes së tij?	
A është respektuar e drejta e të arrestuarit ose e të ndaluarit të takojë vetëm për vetëm mbrojtësin e tij përpara marrjes në pyetje për herë të parë?	
A është respektuar e drejta e të arrestuarit ose e të ndaluarit të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij?	
A është respektuar e drejta e të arrestuarit ose e të ndaluarit të kërkojë që një anëtar i familjes ose një person tjetër i afërt të njoftohet menjëherë për arrestimin e tij?	
Në rast se i arrestuari ose i ndaluar është shtetas i huaj, a është respektuar e drejta e tij të kërkojë të njoftohet përfaqësia konsullore ose diplomatike e vendit të tij?	

Në rast se i arrestuari ose i ndaluari është person pa shtetësi apo refugjat, a është respektuar e drejta e tij të kërkojë të njoftohet përfaqësia konsulllore ose diplomatike e vendit të tij?	
A është respektuar e drejta e të arrestuarit ose të ndaluarit të marrë menjëherë përkujdesjen e nevojshme mjekësore?	
A e ka njoftuar organi procedues të pandehur, të arrestuarin ose të ndaluarin për të drejtat e tij duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar?	
A jemi përpara rastit kur një i pandehur është gjykuar apo dënuar përsëri për të njëjtën veprë penale, për të cilën ai është shpallur i pafajshëm ose është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë?	
A janë vlerësuar si “gjë e gjykuar” veprimet, sjelljet, faktet për të cilat personi është dënuar apo shpallur i pafajshëm me një vendim të formës së prerë?	
Në rast se është paraqitur ankim vetëm nga i pandehuri, a ka caktuar gjykata një dënim më të rëndë ndaj tij?	
Në rast se është paraqitur ankim vetëm nga i pandehuri, a ka zbatuar gjykata një masë sigurimi më të rëndë ndaj tij?	
Në rast se është paraqitur ankim vetëm nga i pandehuri, a i ka dhënë gjykata pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar ose faktit një cilësim juridik më të rëndë?	
A ka caktuar gjykata një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori?	
A e ka filluar gjykata procesin gjyqësor me bindjen se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilin akuzohet?	
A ka vendosur gjykata të deklarojë fajtor të pandehur duke bazuar vetëm në një provë?	
A ka shkuar çdo dyshim lidhur me akuzën në favor të të pandehurit në vendimin e gjykatës i cili ka shpallur fajtor një të pandehur?	
A e ka mbështetur gjykata vendimin në prova të cilat provojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e të pandehurit për kryerjen e veprës penale?	
A ka qenë barra e provës mbi organin e akuzës në vendimin e gjykatës i cili ka shpallur fajtor një të pandehur?	

Në kohën kur ka ndodhur veprimi ose mosveprimi për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri, a parashikohet ky veprim/mosveprim në ligj si vepër penale?	
Në kohën kur ka ndodhur veprimi ose mosveprimi për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri, a parashikohet në ligj lloji dhe masa e dënimit?	
Në rast se ligji i ri nuk e dënon veprën penale, a është proceduar me mosfillimin e ekzekutimit të dënimit ndaj personit të dënuar ose me pushimin e ekzekutimit të dënimit në qoftë se ekzekutimi kishte filluar?	
Në rast se ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm kanë qenë të ndryshëm, a është zbatuar ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale?	
Nëse vepra penale ose dënimi është amnistuar, a është pushuar çështja penale?	
Nëse amnistia e veprës penale ka hyrë në fuqi pas dhënies së vendimit, a është liruar menjëherë i dënuari?	
Nëse kanë kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale, a është filluar procedim penal ndaj personit?	
Nëse kanë kaluar afatet e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, a ka filluar ekzekutimi i dënimit ndaj personit të dënuar?	
A e ka kryer gjykata verifikimin e paraqitjes së palëve para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor?	
Në rast se palët nuk janë paraqitur, a e ka verifikuar trupi gjykues nëse njoftimet janë të rregullta dhe nëse mungesa është e justifikuar?	
A ka urdhëruar gjykata që të përsëritet thirrja për gjykim, kur ka rezultuar që i pandehuri ose personi ndaj të cilit është bërë kërkesë për gjykim nga viktimi akuzuese nuk ka marrë njoftim ose njoftimi është i dyshimtë, rezulton se mungesa është shkaktuar nga forca madhore ose ndonjë pengesë tjetër që e përjashton nga përgjegjësia?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit të zgjedhë deri në dy mbrojtës?	
A i ka siguruar organi procedues menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur janë rastet e mbrojtjes së detyrueshme?	
A i ka siguruar organi procedues të pandehurit që nuk ka mjete financiare të mjaftueshme një mbrojtës nga lista e vendosur në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas?	

A e kanë njoftuar mbrojtësin, gjykata, prokurori dhe policia gjyqësore, kur duhet të kryejnë një veprim për të cilin parashikohet ndihma e tij?	
A i është siguruar të pandehurit të mitur ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit, kujdestarit ligjor ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri?	
A është respektuar e drejta për të pasur një përkthyes?	
A i është njoftuar të pandehurit dhe palëve private nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin akti i ankimit të paraqitur nga prokurori?	
A u janë dhënë palëve mundësi të barabarta për të paraqitur argumente dhe prova?	
A është respektuar e drejta për të pasur kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen?	
A u ka dhënë gjykata palëve kohën e nevojshme dhe të barabartë për të parashtruar pretendimet e tyre?	
Në rastin e përfaqësimit nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit, a u provua që i pandehuri kishte dijeni se ndaj tij ka filluar një proces penal që ai ka hequr dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të?	
A u trajtuan palët në mënyrë të barabartë nga trupi gjykues?	

Metoda e matjes

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja të drejtës për një gjykim të drejtë në procesin penal.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të së drejtës për një gjykim të drejtë në procesin penal.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të së drejtës për një gjykim të drejtë në procesin penal.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

MODULI 2

ZHVILLIMI I GJYKIMIT TË DREJTË NË PROCESIN CIVIL DHE ADMINISTRATIV

Neni 42 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë përcakton se: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.*

E drejta e individëve për t’u ankuar në gjykatë kundër akteve e veprimeve administrative ka për qëllim kontrollin e këtyre të fundit për respektimin e parimeve kushtetuese e ligjore në funksion të realizimit të drejtësisë. Kjo është një garanci e domosdoshme në një shoqëri demokratike për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve dhe një ndër parimet më të rëndësishme kushtetuese që është e drejta e çdo individi për t’u dëgjuar çështja e tij para një gjykate, siç përcaktohet në nenin 42 të Kushtetutës⁴⁸.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, procesi i rregullt ligjor është parashikuar si e drejtë themelore në nenin 42/1 të saj, kurse në nenin 131/f, si shkak për të vënë në lëvizje GjK-në, duke përdorur mjetin e parashikuar në nenin 134/2. Formulimi i kësaj të drejte si “proces i rregullt ligjor” është i qëllimshëm. Kuptimi kryesor i kësaj formule nuk është fakti se ai shtrihet në çdo fushë, pra dhe në atë jashtëgjyqësore. Sado i rëndësishëm të jetë ky kuptim, ai relativizohet po të kemi parasysh se pjesa dërrmuese e çështjeve që lindin për shkak të ligjit ose të zbatimit të tij, në fund të fundit do të shkojë në gjykatë. Kjo formulë ka parasysh në radhë të parë procesin e rregullt në të dyja aspektet: procedural dhe substantiv⁴⁹. Aspekti substantiv dhe ai procedural kushtëzohen sipas faktit nëse procesi fokusohet në drejtësinë e ligjeve ose në atë të zbatimit të tyre. Ky përfytyrim nuk është larg së vërtetës, ndonëse konceptet e normës dhe të zbatimit janë kalimtare sesa mund të duket në pamje të parë. Kështu, një ligj nuk është gjë tjetër veçse një zbatim i Kushtetutës, kurse zbatimi i Kushtetutës mund të të përfundojë me shfuqizimin e një ligji duke u bërë kështu akti i zbatimit (vendimit) dhe individual dhe normativ.

Procesi në kuptimin procedural nuk është gjë tjetër veçse rrjedhë e ndarjes së punës dhe funksioneve në shtet dhe e përkthimit të kësaj në gjuhën e teorisë së sovranitetit parlamentar⁵⁰.

48. Vendim nr.4/2005 i GjK-së.

49. Kristaq Traja, “Procesi i rregullt ligjor”, Revista “Studime Juridike”, nr. 1, 2005, fq. 53.

50. Kristaq Traja, “Procesi i rregullt ligjor”, Revista “Studime Juridike”, nr. 1, 2005, fq. 50.

Procesi i rregullt ligjor përmban këto elemente:

1. gjykimi duhet të jetë i drejtë;
2. gjykimi duhet të jetë publik;
3. gjykimi duhet të zhvillohet brenda një afati të arsyeshëm;
4. gjykimi duhet të zhvillohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme;
5. gjykimi duhet të zhvillohet nga një gjykatë e caktuar me ligj.

Në përputhje me sa më sipër, K.Pr.C., në pjesën e përgjithshme, ashtu dhe në atë të posaçme, zbërthen e zhvillon më tej në sensin pozitiv atë çfarë garanton Kushtetuta. Kështu, në nenin 31 Kodi e përkufizon padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që bën pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar në fakte e në ligje ose jo, kurse neni 32, shkronja "a", parashikon se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur⁵¹.

1. E drejta e mbrojtjes

Parimi i procesit të rregullt gjyqësor ka si element të vetin edhe të drejtën e secilës palë për të qenë e pranishme në seancë gjyqësore. Jurisprudenca kushtetuese dhe praktika e GjEDNj-së kanë përcaktuar standarde edhe për pjesëmarrjen në gjykim, me qëllim që t'i krijohej mundësitë secilës palë për të mbrojtur efektivisht të drejtën që pretendohet si e shkelur. Pjesëmarrja e palëve në gjykim, dëgjimi i pretendimeve të tyre për provat e interpretimin e ligjit në çështjen konkrete, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës e neni 6 i KEDNj-së, sepse kjo pjesëmarrje shërben për të mbrojtur në substancë të drejtat e secilës palë. Krijimi i kushteve për të bërë një mbrojtje efektive është jo vetëm në interes të palëve, por edhe në interes të drejtësisë⁵².

E drejta e shtetasve për t'u mbrojtur përbën thelbin e konceptit që jurisprudenca kushtetuese ka krijuar për procesin e rregullt ligjor. E drejta për të qenë i pranishëm në gjykim është një pjesë përbërëse e të drejtës për t'u mbrojtur. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë palët dhe mbrojtësit e tyre, në kohë të mjaftueshme, për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar padrejtësisht nga gjykimi. Kjo është një praktikë tashmë e njohur dhe e konsoliduar e GjK-së dhe e GjEDNj-së, sipas të cilës do të ishte pa vlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces, në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim.⁵³

Palë në një proces civil janë subjektet e mosmarrëveshjes gjyqësore kundrejt të cilave gjykata e cila gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet me vendim. Palë në proces janë ndërgjyqësit e procesit.

51. Vendimi nr. 5/2006 i GjK-së.

52. Vendim nr. 8/2006 i GjK-së. Vendim nr. 34/2007 i GjK-së.

53. Vendim nr. 109/2002 i GjK-së. Vendim nr. 11/2005 i GjK-së. Vendim nr. 27/2009 i GjK-së.

Paditësi është pala ndërgjyqëse e cila ka legjitimitet aktiv atëherë kur ai ka një interes të ligjshëm për të ngritur padinë, që synon angazhimin e gjykatës për të mbrojtur dhe vënë në vend të drejtat dhe interesat e ligjshme të shkelura⁵⁴. Paditësi është pala që vë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor. Ai është i lirë që në çdo kohë të tërheq padinë, por gjithnjë përpara shuarjes së saj për efekt gjykimi ose në bazë të ligjit⁵⁵. Paditësi është subjekti që paraqet kërkimin e objektit të padisë, të cilin e shqyrton gjykata e cila në përfundim të gjykimit e shpall atë të bazuar ose jo.

Ndërsa i padituri është pala me legjitimitet pasiv, që fiton cilësinë e palës ndërgjyqëse, në bazë të një akti të tjetërkujt dhe kundrejt tij ngrihet e drejtohet kërkimi i padisë. Ai paraqet prapësimet mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij kërkimi. Pala me legjitimitet pasiv mund të kthehet në palë me legjitimitet aktiv, duke përdorur ato mjete mbrojtëse që ligji i ka njohur palës së paditur (si kundërpadi etj.), në mënyrë që ajo të arrijë të realizojë mbrojtjen e të drejtave të saj⁵⁶.

Përcaktimi dhe rregullimi i ndërgjyqësisë është një e drejtë që e gëzon vetëm paditësi dhe palët në proces, ndërsa gjykata në rolin që i ka dhënë ligjvënësi, mundet vetëm t'i orientojë ata në lidhje me rregullimin e ndërgjyqësisë, por në asnjë rast nuk mund t'i detyrojë ata të përcaktojnë se "*kush*" do të jetë palë në proces⁵⁷. Ndonëse gjykata nuk ka rol aktiv dhe nuk mund të përcaktojë e urdhërojë thirrjen në gjykim të një subjekti në pozitën e paditësit apo të paditurit, ose ndryshimin e pozitës procedurale të palës, ajo bën kujdes dhe njëkohësisht ka detyrimin, veçanërisht në fazën e veprimeve përgatitore, për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes dhe rrjedhimisht edhe për të shqyrtuar e orientuar rregullësinë e ndërgjyqësisë së përcaktuar nga ana e paditësit. Gjukata kujdeset që palët e treguara në padi, si dhe palët e thirrura në gjykim edhe kryesisht prej saj si persona të tretë, të njihen me çështjen, të orientoohen dhe t'u krijohen kushtet për të ushtruar të gjitha të drejtat që ju njeh ligji, përfshirë për shembull edhe ato që lidhen me pozitën procedurale të tyre dhe mundësinë e hapësirën që parashikon ligji për ndryshimin e kësaj pozite apo daljen jashtë gjykimit⁵⁸.

Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të paditurve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit⁵⁹.

Ligjvënësi e ka përcaktuar mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë si shkelje të rëndë procedurale e cila në rast se konstatohet nga Gjukata e Apelit⁶⁰ dhe GjL⁶¹ përbën shkak për dërgimin e çështjes për rigjykim. Situata më e përsëritur e cenimit të së drejtës së mbrojtjes,

54. Vendim nr. 190/2010 i GjL-së.

55. Neni 2 K.Pr.C.

56. Vendim nr. 168/2010 i GjL-së.

57. Vendim Unifikues i GjL-së nr. 1/2012.

58. Vendim nr. 152/2012 i GjL-së.

59. Neni 161 paragrafi i dytë i K.Pr.C.

60. Neni 467/d i K.Pr.C.

61. Neni 472/2 i K.Pr.C.

është rasti kur me zgjidhjen e një çështjeje preken edhe të drejtat dhe interesat e një subjekti pa u thirrur në cilësinë e palës së paditur, duke i mohuar në këtë mënyrë të drejtën e mbrojtjes.

Me qëllim që të garantohet pjesëmarrja e rregullt e palëve në proces, thirrja në gjykatë bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjes, e cila duhet të përmbajë gjykatën që e ka nxjerrë, emrin, mbiemrin e personit të thirrur, kohën e vendin e seancës gjyqësore, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, kohën e njoftimit të aktit, si dhe pasojat ligjore në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë. Rregullat për njoftimin e palëve në gjykatë parashikohen në nenet 129 - 144/a të K.Pr.C.

Thirrja në gjykatë bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjes, e cila duhet të përmbajë gjykatën që e ka nxjerrë, emrin, mbiemrin e personit të thirrur, kohën e vendin e seancës gjyqësore, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, kohën e njoftimit të aktit, si dhe pasojat ligjore në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë.

Njoftimi shkresor bëhet nëpërmjet dorëzimit nga punonjësi i gjykatës ose shërbimi postar i letërthirrjes ose akteve të tjera që duhet t'i njoftohen personit të thirrur, kudo ku ai gjendet.

Në rastin e personave që ndodhen në shërbim në ushtri, njoftimi u bëhet me anë të komandës së repartit nga i cili varen.

Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve.

Në rastin e personave juridikë privatë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet përfaqësuesit ose personit të ngarkuar për të marrë aktet dhe, në mungesë të tyre, një personi tjetër që punon në këtë qendër të personit juridik.

Në rastet kur njoftimi shkresor bëhet nëpërmjet shërbimit postar, punonjësi i gjykatës shënon mbi origjinalin dhe mbi kopjen e njoftimit edhe zyrën e postës, me anë të së cilës i është dërguar akti marrësit, me dërgesë të porositur. Dëftesa e marrjes në dorëzim duhet t'i bashkohet origjinalit të aktit dhe përfshihet në dosjen gjyqësore.

Në qoftë se personi të cilit i drejtohet njoftimi refuzon marrjen e njoftimit, nuk di ose nuk mund të nënshkruajë, punonjësi i gjykatës ose punonjësi i shërbimit postar bën shënimin përkatës në aktin objekt njoftimi dhe, kur është e mundur, e vërteton edhe me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast njoftimi quhet i kryer.

Kur nuk është i mundur njoftimi sipas procedurave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e personit të thirrur ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale ose të artizanatit.

Në qoftë se personi i thirrur nuk gjendet në një nga këto vende, njoftimi i dorëzohet një personi të familjes që ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe kur nuk ndodhet

ndonjë prej tyre, njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet fqinjëve, që pranojnë t'ia dorëzojnë atë personit të thirrur, zyrës ose qendrës së punës së tij, përveç kur marrësi është i mitur, nën gjashtëmbëdhjetë vjeç ose është i pazoti për të vepruar.

Kur nuk është e mundur të bëhet njoftimi, sipas paragrafit të mësipërm, kopja e njoftimit i dorëzohet portierit të ndërtesës së banimit, të zyrës apo të qendrës së punës.

Në të gjitha këto raste, personi që merr njoftimin, duhet të nënshkruajë origjinalin ose kopjen e saj, duke marrë përsipër detyrimin që kopjen tjetër t'ia dorëzojë personit të thirrur. Gjithashtu bëhet shënimi në kopjen që mban punonjësi i gjykatës edhe për marrëdhëniet e këtij personi me personin e thirrur, veprimet dhe kërkimet e bëra nga nëpunësi gjyqësor për dorëzimin e aktit personit të thirrur, si dhe vendin dhe kohën e dorëzimit.

Kur anëtarët e familjes së personit që i drejtohet njoftimi, ose fqinjët të cilëve u jepet njoftimi për t'ia dorëzuar personit të cilit i drejtohet njoftimi, nuk pranojnë të marrin në dorëzim njoftimin, nuk dinë ose nuk mund të nënshkruajnë, bëhet shënimi në kopjen e njoftimit dhe, kur është e mundur, vërtetohet edhe me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast njoftimi quhet i kryer.

Njoftimi bëhet me shpallje publike nëse:

a) nuk është e mundur të realizohet njoftimi sipas parashikimeve të mësipërme dhe pasi punonjësi i gjykatës ka marrë të gjitha masat e nevojshme për gjetjen e adresës së personit që i drejtohet njoftimi; ose

b) personi, të cilit i drejtohet njoftimi, nuk ka vendbanim, vendqëndrim, nuk ka zgjedhur një banesë ose nuk ka caktuar një përfaqësues në Republikën e Shqipërisë dhe nuk ka qenë i mundur njoftimi i tij sipas njëres nga mënyrat e parashikuara nga ligji.

Njoftimi me shpallje publike kryhet me anë të afishimit të tij në gjykatën e vendit ku do të gjykohet mosmarrëveshja, në vendin ku personi të cilit i drejtohet njoftimi ka vendbanimin ose në vendqëndrimin e tij, si edhe në njësinë administrative në të cilën ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

Kur personi të cilit i drejtohet njoftimi është një person juridik privat, njoftimi kryhet me anë të afishimit të tij në selinë e regjistruar në regjistrat publikë përkatës.

Njoftimi botohet edhe në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës, dhe/ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim.

2. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti

Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë

mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë.⁶² Në këtë mënyrë, zbatimi i parimit të kontradiktoritetit duke dëgjuar më përpara të dyja palët në mosmarrëveshje, është një mënyrë logjike dhe etike, i cili i lejon gjyqtarit të vendosë për të "vërtetën" nëpërmjet bashkëpunimit me palët⁶³.

Jurisprudenca e GjEDNj-së, e ka ngritur parimin e kontradiktoritetit në nivelin e KEDN-së, duke e konsideruar si një element të domosdoshëm të një gjykimi të drejtë⁶⁴.

Gjykata, pasi deklarohet çelja e seancës gjyqësore, verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja ato nuk janë paraqitur në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkak sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër. Gjykata verifikon legjitimitimin e personave ose të përfaqësuesve të tyre të paraqitur si palë dhe kur është rasti i fton ata të plotësojnë aktet dhe dokumentet që rezultojnë me të meta, duke përfshirë këtu edhe aktet lidhur me përfaqësimin, gjetjen e personit dhe kur e sheh të nevojshme, u cakton palëve një afat. Gjykata duhet të zbatojë parimin e kontradiktoritetit në gjykimin e çështjes, duke e mbështetur vendimin e saj vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të treguara ose të sjella nga palët (neni 20 i K.Pr.C.). Të dyja palët ndërgjyqëse duhet të kenë pozitiv procedurale të njëjtë dhe mundësi përfaqësimi të njëjtë, në mënyrë që të kenë paraqitje të plotë dhe të barabartë të fakteve, deklaramëve, provave në proces etj.⁶⁵

Parimi i kontradiktoritetit është ndër parimet më të rëndësishme që duhet të karakterizojnë procesin gjyqësor në kuptim edhe të neneve 18, 19 dhe 20 të K.Pr.C, lidhet me të drejtën e palëve ndërgjyqëse për t'u dëgjuar, për t'i bërë të njohur provat/pretendimet njëra-tjetrës në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat ato mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore, me qëllim realizimin sa më të drejtë të

62. Vendim nr. 19/2003 i GjK-së. Vendim nr. 23/2007 i GjK-së. Vendim nr. 34/2011 i GjK-së. Vendim nr. 18/2013 i GjK-së. Vendim nr. 51/2013 i GjK-së. Vendim Dehaes dhe Giples kundër Belgjikës, datë 04/02/1997, GjEDNj; Vendim Dombo Behere kundër Holandës, datë 27/10/1993, GjEDNj; Vendim Stratis Andreadhis kundër Greqisë datë 09/12/1994, GjEDNj; Vendim Ruiz-Mateos, kundër Spanjës datë 23/06/1993, GjEDNj.

63. Nicola Picardi, Manuale del processo civile, seconda edizione, Giuffrè Editore, faqe 3.

64. Vendim i GjEDNj-së Vermeulen kundër Belgjikës; datë 20/02/1996; Vendim i GjEDNj-së Nideröst-Huber kundër Zvicrës datë 18/02/1997.

65. Vendim nr. 255/2010 i GjL-së.

parimit të mbrojtjes së interesave të tyre në gjykim.⁶⁶ Parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që këto të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen.⁶⁷

Një aspekt shumë i rëndësishëm me sa më sipër është rasti kur gjykata vendos kryerjen e aktit të ekspertimit nëpërmjet të cilit konstatohen ose sqarohen fakte, që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim dhe për të cilat kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit⁶⁸. Mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën, e cila e vlerëson atë duke pasur parasysh edhe provat e tjera të cilat janë paraqitur gjatë hetimit gjyqësor. Gjykata ka për detyrë që në vendimin e saj të japë argumentet ligjore, si në rastin kur zgjidhjen e bazon në përfundimet e dhëna nga eksperti, ashtu edhe të argumentojë të kundërtën kur atë nuk e merr parasysh⁶⁹. Referimi vetëm në atë çka ka konstatuar eksperti, dhe më tepër ndryshe nga këto konstatime, madje pa parashtruar as arsyetimin e saj, pa analizuar në vendim provat e tjera shkresore të administruara, përbën qëndrim të gabuar të gjykatës, sepse ajo në këtë mënyrë ngatërron rolin e saj me atë të ekspertëve.

E drejta e gjykatës për ta zgjidhur çështjen duke mos u bazuar te përfundimet e aktit të ekspertimit, lidhet vetëm me të drejtën e saj për ta vlerësuar aktin e ekspertimit në krahasim edhe me provat e tjera, por kurrësi gjykata nuk ka hapësirë dhe autoritet ligjor për të arsyetuar lidhur me analizën shkencore e teknike që kanë bërë ekspertët dhe as për të çmuar e vlerësuar nëse ishin apo jo të mjaftueshme provat shkresore që ekspertët kishin në dispozicion për të hartuar aktin e ekspertimit dhe për të dhënë përfundimet e tyre shkencore. Këtë e dinë dhe vlerësojnë vetë ekspertët, për shkak se nuk janë gjykatat, por vetë ekspertët ata që janë përzgjedhur për të dhënë mendim shkencor (pra jo mendim juridik) pikërisht sepse ata kanë njohuritë e posaçme teknike e shkencore për fushën e ekspertimit që janë ngarkuar për të zhvilluar, njohuri të cilat nuk i kanë gjyqtarët.⁷⁰

Eksperti në kryerjen e aktit të ekspertimit duhet të mbështetet vetëm mbi provat që ndodhen në fashikullin gjyqësor, të cilat janë lejuar të merren nga gjykata dhe që i janë nënshtruar debatit gjyqësor ndërmjet palëve. Në rast se akti i ekspertimit do të ishte i pambështetur në provat e administruara në dosje, do të nxirrte përfundime hipotetike dhe për rrjedhojë do t'i mungonte edhe arsyetimi, atëherë gjykata nuk mund të pranojë dhe të bazohet në zgjidhjen e çështjes te përfundimet e aktit e ekspertimit.⁷¹

66. Vendim nr.69/2000 i GjK-së.

67. Vendim nr.19/2005 i GjK-së; Vendim nr.5/2003 i GjK-së; Vendim nr.33/2003 i GjK-së; Vendim nr.16/2006 i GjK-së; Vendim nr.13/2008 i GjK-së; Vendim nr.28/2009 i GjK-së; Vendim nr.30/2009 i GjK-së; Vendim nr 38/2010 i GjK-së.

68. Vendim nr. 459/2013 i GjL-së arsyeton se: “gjykata është e detyruar që të thërrasë një ekspert me njohuri të posaçme nga fusha përkatëse dhe jo siç arsyeton gjykata e apelit se meqenëse ndodhemi përpara një veprimi të thjeshtë matematikor nuk ka nevojë për kryerjen e ekspertimit”.

69. Vendim nr. 18/2010 i GjL-së.

70. Vendim nr. 582/2012 i GjL-së.

71. Vendimi Unifikues i GjL-së nr. 628/2000; Vendim nr. 117/2009 i GjL-së; Vendim nr. 331/2009 i GjL-së.

Pra, ekspertimi është mënyra me të cilën gjykata vlerëson njohuritë e posaçme të shkencës e të teknikës, në hetimin e rrethanave të një konflikti gjyqësor. Specialistëve të fushave të tjera të shkencës e teknikës që thirren për të kryer ekspertimin t'u vihen në dispozicion provat shkresore apo provat e çdo natyre, të marra nga gjykata konform normave procedural. Në të kundërt, akti i ekspertimit do të ishte me të meta dhe i mangët dhe nga ana tjetër, vendimit të gjykatës do t'i mungonte argumentueshmëria.⁷²

Kjo pasi procesi civil, ka për qëllim zhvillimin e një gjykimi që konsiston në vlerësimin nga pikëpamja e së drejtës të një fakti ose një grup faktesh, por domosdoshmërisht këto të fundit para se të vlerësohen nga gjykata duhet të vërtetohen. Nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm vetëm vlerësimi i pretendimeve të palës dhe përfundimeve të aktit të ekspertimit për të arritur në konkluzionin se pretendimi është i mbështetur në ligj dhe në prova.⁷³ Nëse gjykata do të pranonte përfundimet e aktit të ekspertimit si mësipër, njërës palë do t'i cenohej parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, pasi jo vetëm që pretendimet e palës tjetër nuk do të bazoheshin mbi bazën e provave të paraqitura gjatë hetimit gjyqësor, por dhe nga ana tjetër pala do të vendosej në pamundësi për të kundërshtuar konkluzionet e ekspertit, pasi nuk do të ishin të marra mbi prova të cilat mund të diskutoheshin apo paraqiteshin pretendime rreth tyre gjatë hetimit gjyqësor.

3. Parimi i sigurisë juridike

Siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës dhe kjo siguri presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Koncepti i besueshmërisë ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme.

Në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar, parim që pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Sipas nenit 451/a të K.Pr.C, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar, është shprehje e konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje⁷⁴. Parimi në bazë të së cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë, është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një vendim përfundimtar është një element themelor i të drejtës për një gjykim të drejtë që garantohet nga neni 6 i KEDNj-së në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga

72. Vendim nr. 573/2014 i GjL-së.

73. Vendim nr. 593/2014 i GjL-së.

74. Vendim nr. 24/2008 i GjK-së; Vendim nr. 15/2012 i GjK-së; Vendim nr. 9/2007 i GjK-së.

gjykatat, ajo duhet të vendoset një herë e përgjithmonë⁷⁵.

Kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit me kusht, që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj⁷⁶. K.Pr.C. në nenin 451 përcakton rastet kur një vendim merr formë të prerë. Në bazë të kësaj dispozite:

“Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:

- a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij;*
- b) nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr;*
- c) ankesa e paraqitur nuk është pranuar;*
- ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.”*

Gjithashtu, neni pasardhës⁷⁷, parashikon efektet e një vendimi të formës së prerë, atë që në terminologjinë juridike përbën “gjë të gjykuar”. Më konkretisht në të parashikohet: *“Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.*

Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.”

Në procesin civil, gjëja e gjykuar mbulon jo vetëm kërkimet, por edhe prapësimet e parashtruara apo që mund dhe duhet të ishin parashtruar për të kundërshtuar faktet konstitutive të së drejtës së pretenduar në gjykim nga ana e paditësit apo kundërpaditësit. Pra, autoriteti, fuqia e gjësë së gjykuar, mbulon jo vetëm kërkimet e prapësimet e bëra gjatë gjykimit (e njohur si *autoriteti i gjësë së gjykuar të shprehur*), por edhe të gjitha ato që mund dhe duhet të bëheshin me anë të ngritjes së padisë, kundërpadisë dhe prapësimeve, të cilat, ndonëse të patrajtuara në vendimin e formës së prerë, prezumohen, bëjnë pjesë në mënyrë të pashmangshme në logjikën juridike të arsyetimit, të përfundimeve dhe urdhërimeve të vendimit gjyqësor të formës së prerë (e njohur si *autoriteti i gjësë së gjykuar të heshtur, të nënkuptuar*)⁷⁸.

75. Vendim GjEDNj Kehaya dhe të tjerë kundër Bulgarisë.

76. Vendim nr. 24/2008 i GjK-së.

77. Neni 451/a i K.Pr.C.

78. Vendim nr. 484/2006 i GjL-së.

Vendimi gjyqësor i formës së prerë ka karakter të detyrueshëm kundrejt palëve. Fuqia detyruese e vendimit gjyqësor karakterizohet në detyrimin që kanë palët pjesëmarrëse në proces ose personat që u rrjedhin përfitime prej tyre, që të respektojnë të gjitha detyrimet e caktuara nga vendimi gjyqësor, por jo mbi të tjerët që nuk kanë qenë palë në gjykim.

Me shprehjen “Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët...” kuptohet se palët në marrëdhëniet e tyre për çështjen e gjykuar duhet t’u përmbahen pikërisht urdhërimeve të këtij vendimi. E njëjta gjë kuptohet edhe për trashëgimtarët e tyre dhe për personat e tjerë, që heqin të drejta nga palët (qoftë nga gjyqfituesi apo gjyqthumbësi), për sa i përket zgjidhjes që përmban vendimi gjyqësor i formës së prerë për marrëdhëniet midis palëve. Pra, fuqia detyruese e vendimit të formës së prerë shtrihet edhe mbi personat që heqin të drejta nga palët dhe jo mbi të tjerët që nuk kanë qenë pjesëmarrës në gjykim.

Në këtë kuptim, urdhërimi konkret i një vendimi gjyqësor i formës së prerë shtrin efektet e tij juridike ndaj palëve pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, trashëgimtarëve të tyre dhe personave që tërheqin të drejta prej palëve (si në rastet e neneve 199 e 200 të K.Pr.C.).

I ndryshëm është pozicioni i personit të tretë që nuk ka qenë palë në gjykim. Për të tretët, vendimi gjyqësor i dhënë nuk ka asnjë rëndësi të veçantë, veç si një ngjarje e ndodhur midis personave të tjerë dhe konsiderohet për atë që është dhe për atë që vlen në lidhje me ta, të cilët mund të pretendojnë se janë titullarë të një të drejte të pavarur dhe të papajtueshme me urdhërimin e përfshirë në vendimin gjyqësor.

Personat e tretë, në qoftë se nuk kanë qenë thirrur në gjykim apo nuk kanë ndërhyrë në të, mund të kundërshtojnë të drejtën e njohur personave të gjykimit të zhvilluar me anë të një padie të re. Pra, kur flitet për “konflikt gjyqësor” dhe për vendim gjyqësor që përbën *res judicata*, nuk përfshihen personat e tretë që nuk kanë qenë pjesëmarrës në gjykimin e zhvilluar, pavarësisht nga arsyet⁷⁹.

4. Parimi i disponibilitetit

Në përputhje me parimet e sanksionuara në nenin 42 të Kushtetutës, K.Pr.C. rregullon/ implementon të drejtën e aksesit në një sërë dispozitash të tij. Kështu, Kodi parashikon të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë, e cila duke pasur parasysh natyrën e saj si arbitër, nuk procedon me nismën e saj, nëse nuk vihet në lëvizje nga palët. Iniciativa për të filluar procesin i takon palës së interesuar, sepse gjykata nuk merr në shqyrtim një mosmarrëveshje nëse këtë nuk e kërkon i interesuari (neni 2 i K.Pr.C.)⁸⁰. Ky parim formalizohet me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim në gjykatë⁸¹, përcaktimin e përmbajtjes së padisë nga paditësi⁸², heqjen dorë nga gjykimi i padisë ose nga e drejta e padisë⁸³ etj.

79. Vendim nr. 606/2014 i GjL-së.

80. Vendim nr. 18/2009 i GjK-së.

81. Neni 153 i K.Pr.C.

82. Neni 154 i K.Pr.C.

83. Neni 201 i K.Pr.C.

Lidhur me parimin e disponibilitetit paraqet rëndësi edhe qëndrimi që duhet të ketë gjykata ndaj padisë. Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet. Ajo është e detyruar të disponojë vetëm dhe për të gjitha kërkimet e objektit të padisë. Gjykatat kanë për funksion të zgjidhin konfliktet midis palëve duke dhënë drejtësi nëpërmjet zgjidhjes së këtyre rasteve sipas dispozitave ligjore dhe normave të tjera në fuqi dhe janë të kufizuara në këtë funksion nga kërkimet e palëve (nenet 2/1, 6, 28). Drejtësia e dhënë nga gjykatat është gjithmonë konkrete dhe nuk mund të jetë qëllim në vetvete⁸⁴.

Përrjashtimisht, pasi është vënë në lëvizje nga palët, por nuk ka kërkesë, prapësim apo ankim, gjykata kryesisht mund të konstatojë pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik si edhe gjykata më e lartë mund të marrë në shqyrtim kryesisht dhe të prishë vendimin e gjykatës më të ulët nëse gjykimi është zhvilluar dhe vendimi është dhënë në shkelje të rëndë procedurale sikurse janë, veç të tjerave rastet e parashikuara nga neni 467 i K.Pr.C., mungesa apo pavlefshmëria e njoftimeve, pavlefshmëria e vendimit gjyqësor etj. Pasojat e ardhura nga ekzekutimi (përbushja) e një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm zgjidhen vetëm mbi kërkesën e palëve ndërgjyqëse dhe në rastin kur gjykata kryesisht konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik ajo zgjidh vetëm ato pasoja që janë objekt kërkimi të padisë apo të kundërpadisë, pa u shprehur për pasojat për të cilat nuk ka kërkesë konkrete nga palët. Kjo nuk pengon po këto palë apo persona të tretë të mund të kërkojnë në një tjetër gjykim zgjidhjen e pasojave të lëna në heshtje nga gjykimi ku veprimi juridik është konstatuar absolutisht i pavlefshëm. Shkelja e këtij parimi procedural përbën një shkelje me karakter kushtetues, pasi lidhet drejtpërdrejt me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës⁸⁵.

Parimi i disponibilitetit lidhet edhe me parimin e disponibilitetit të provave (*iuxta alligata ac probata*). Gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor. Për rrjedhojë, pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj (neni 12 i K.Pr.C.). Pala paditëse ka detyrimin që të provojë bazueshmërinë e themelit të kërkimeve që ka paraqitur në objektin e padisë, ndërsa pala e paditur ka detyrimin të provojë bazueshmërinë e prapësimin për rrëzimin e kërkimit të objektit të padisë si të pabazuar në ligj. Në respektim të parimit të disponibilitetit të provës, janë pikërisht palët në proces atyre të cilave u bie barra e provës për të parashtruar faktet e dobishme të rëndësishme, të domosdoshme, për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, mbi të cilat ato mbështesin kërkimet dhe pretendimet e tyre. Kjo barrë procedurale që u është vendosur palëve përcakton dhe kufirin që ka pushteti gjyqësor në gjykim, e cila duhet të vendosë në themel të vendimit të saj provat e paraqitura nga palët⁸⁶.

Nga ana tjetër, gjykata në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ka për detyrë të kryejë një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin (neni 14 i K.Pr.C.).

Fryma që karakterizon K.Pr.C. është përcaktimi si rregull i një roli kryesisht pasiv për gjykatën (me përjashtime të mirëpërcaktuara kryesisht sa i përket fazës së hetimit gjyqësor). Konform

84. Vendim nr. 293/2010 i GjL-së.

85. Vendim nr. 61/2001 i GjL-së.

86. Vendim nr. 366/2013 i GjL-së.

nenit 6 të K.Pr.C., gjykata kur gjykon mosmarrëveshjet e ndryshme duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet. Gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor (neni 8 i K.Pr.C.) dhe nuk vepron me iniciativë (*ex officio*) për hetimin e fakteve që nuk paraqiten nga palët në themel të pretendimeve të tyre⁸⁷.

Megjithëse ligji procedural, në parim, ngarkon palën që pretendon një të drejtë me barrën që të sjellë provat në mbështetje të qëndrimeve të saj, K.Pr.C., jo rastësisht, parashikon edhe situata kur “barrën e provës”, pala që pretendon, e realizon nëpërmjet ndërhyrjes aktive të gjykatës në kërkimin dhe marrjen e provës, sidomos kur pengohet nga të tretë që ta marrë provën apo prova mbahet nga pala tjetër në gjykim⁸⁸.

Bazuar në nenin 223 të K.Pr.C., gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj. Gjithashtu bazuar në nenin 224 të K.Pr.C., gjykata mund të kërkojë zyrtarisht nga organet e administratës publike të dhëna me shkrim për akte dhe dokumente që ndodhen në atë organ dhe që është e nevojshme të shqyrtohen në procesin gjyqësor.

5. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A është përcaktuar saktë subjekti të cilit i janë shkelur të drejtat dhe interesat e ligjshme dhe legjitimohet të kërkojë rivendosjen e tyre?	
A është përcaktuar saktë subjekti kundrejt të cilit drejtohet kërkimi i padisë?	
Në rast se nuk është përcaktuar në mënyrë të rregullt ndërgjyqësia, a ka marrë masa gjykata për orientimin e palëve për rregullimin e saj?	
Në rast se nuk është formuar drejt ndërgjyqësia, a është rrëzuar padia nga gjykata e shkallës së parë?	
Në rast se gjykata e shkallës së parë ka vendosur për pranimin e padisë dhe ndërgjyqësia nuk ka qenë e rregullt, a është prishur vendimi i gjykatës nga gjykatat më të larta?	
A është realizuar njoftimi i palëve në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj për datën dhe orarin e seancës gjyqësore?	
A janë njoftuar rregullisht palët ose përfaqësuesit e tyre nga sekretari ose punonjësi i gjykatës për të zënë vendet e caktuara në sallë/zyrë përpara se të fillojë seanca gjyqësore?	

87. Vendim Unifikues i GjL-së nr. 3/2012.

88. Vendim nr. 37/2013 i GjL-së; Vendim nr. 128/2013 i GjL-së.

A është verifikuar nga gjykata paraqitja e palëve në seancë?	
Në rast se ndonjë nga palët nuk është paraqitur, a është verifikuar nga gjykata nëse ka pasur shkaqe të ligjshme që justifikojnë mosparaqitjen e saj?	
Në rast se pala/palët janë përfaqësuar nga përfaqësues, a është verifikuar nga gjykata nëse janë pajisur me akt përfaqësimi në përputhje me ligjin dhe për tagrat e përfaqësimit?	
A u ka dhënë mundësi gjykata palëve të mbrohen nëpërmjet përfaqësuesve të parashikuar në ligj?	
Në rast se paditësi nuk është paraqitur në seancë pa ndonjë shkak të ligjshëm, a ka vendosur gjykata pushimin e gjykimit?	
A e ka ftuar gjykata secilën nga palët të paraqesë faktet dhe provat mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre?	
A iu është dhënë palëve i njëjti akses në dokumentet gjyqësore?	
A u ka dhënë gjykata palëve kohën e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen (paraqitjen e pretendimeve dhe provave)?	
A u ka dhënë gjykata palëve kohën e nevojshme dhe të barabartë në dispozicion për të parashtruar pretendimet e tyre?	
A u trajtuan palët në mënyrë të barabartë nga trupi gjykues?	
A e ka mbështetur gjykata vendimin vetëm mbi pretendimet, faktet dhe provat që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor?	
A e ka mbështetur gjykata vendimin në përfundimet e aktit të ekspertimit?	
Në rast se gjykata nuk e ka mbështetur vendimin në përfundimet e aktit të ekspertimit, a është arsyetuar me hollësi ky mendim në vendimin përfundimtar ose në një vendim të dhënë gjatë gjykimit?	
A ka qenë gjykata përpara ndonjë prej rasteve të parashikuara në ligj të cilat përcaktojnë kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë?	
A është zbatuar fuqia detyruese e vendimit të formës së prerë për palët dhe mbi personat që heqin të drejta nga palët?	
A është zbatuar fuqia detyruese e vendimit të formës së prerë mbi të tjerët që nuk kanë qenë pjesëmarrës në gjykim?	
A janë vlerësuar si “gjë e gjykuar” jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit?	

A janë vlerësuar si “gjë e gjykuar” jo vetëm kërkimet dhe prapësimet e parashtruara, por edhe kërkimet dhe prapësimet që mund dhe duhet të ishin parashtruar?	
A e ka pranuar gjykata për gjykim kërkesëpadinë në rastet kur në përmbajtjen e saj nuk plotësohen elementet formale për marrjen në shqyrtim?	
A u ka lënë kohë gjykata palëve për të rregulluar të metat e padisë?	
A ka ndikuar trupi gjykues nëpërmjet sugjerimeve/kërkesave për ndryshimin, pakësimin apo shtimin e objektit të padisë?	
A është shprehur gjykata në vendim mbi gjithçka që është kërkuar nga paditësi në kërkesëpadi?	
Në rast se gjykata në vendim është shprehur edhe për kërtime që nuk janë parashtruar nga paditësi në kërkesëpadi, a ka qenë përpara rasteve përjashtimore të parashikuara në ligj?	
A është shprehur gjykata në vendim vetëm për atë që është kërkuar nga paditësi në kërkesëpadi?	
A i ka pranuar gjykata kërkesat e palëve për pakësimin, shtimin dhe ndryshimin e objektit të padisë kur plotësoheshin kushtet e parashikuara në ligj?	
A i ka pranuar gjykata kërkesat e palëve për heqjen dorë nga gjykimi i padisë ose nga e drejta e padisë kur plotësoheshin kushtet e parashikuara në ligj?	

Metodat e matjes

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës për një gjykim të drejtë në procesin penal.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të së drejtës për një gjykim të drejtë në procesin penal.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të së drejtës për një gjykim të drejtë në procesin civil dhe administrativ.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

MODULI 3

GJYKIMI NGA NJË GJYKATË E CAKTUAR ME LIGJ

1. Kompetenca lëndore dhe tokësore e gjykatës në gjykimin civil dhe administrativ

Një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNj-së është dhe shqyrtimi i çështjes nga një *“gjykatë e caktuar me ligj”*. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit⁸⁹. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit⁹⁰. Objekti i termit *“gjykatë e caktuar me ligj”* në nenin 42/2 të Kushtetutës, është të sigurojë që organizimi gjyqësor në një shoqëri demokratike të mos varet në diskrecionin e ekzekutivit, por të rregullohet me ligj të parlamentit. Shprehja *“gjykatë e caktuar me ligj”* mbulon jo vetëm bazën ligjore për ekzistencën e vetë *“gjykatës”*, por edhe përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për gjykimin e çdo çështjeje konkrete⁹¹.

Në aspektin kushtetues, kompetenca lëndore apo funksionale e gjykatës është shumë e rëndësishme, si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Në jurisprudencën e GjK-së, koncepti juridik i kompetencës është trajtuar nën standardin e gjykatës së caktuar me ligj, si pjesë përbërëse e nenit 42/1 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNj-së⁹². Në këtë linjë arsyetimi, kompetenca lëndore apo funksionale është kusht për vlefshmërinë e procesit gjyqësor dhe të akteve të realizuara gjatë tij në kuptimin që një gjykatë jokompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale. Ky konkluzion e ka bazën te postulati: *“Nuk mund të ketë bindje ndaj një gjyqtari jokompetent”*⁹³. Kur flitet për caktimin e gjykatës së caktuar me ligj, ky standard implikon disa dimensione:

Së pari, gjykata të jetë konstituar nga ligji, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore/funksionale dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve;

89. Vendim nr.31/2005 i GjK-së; Vendim nr.7/2009 i GjK-së.

90. Vendim nr. 27/2009 i GjK-së.

91. Vendim nr. 18/2007 i GjK-së.

92. Vendim nr.23/2009 i GjK-së. Vendim nr.7/2009 i GjK-së. Vendim nr.31/2005 i GjK-së. Vendim nr.16/2012 i GjK-së.

93. Vendimi nr. 00-2020-13/2020 i GjL-së.

Së dyti, ligji të ketë caktuar mënyrën dhe momentin se si gjykata merr juridiksion dhe kompetencë. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete. Në çdo rast gjykata, për identifikimin e kompetencës lëndore/funksionale dhe për identifikimin e ligjit të zbatueshëm, që përcakton kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e çështjes konkrete, i referohet objektit dhe shkakut ligjor të padisë, të cilat individualizojnë edhe natyrën e mosmarrëveshjes apo lëndën e gjykimit.

Ndërkohë, sipas standardeve të përcaktuara nga GjEDNj, kjo e fundit në çështjen Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës, në 12 mars 2019 ka përcaktuar dy nocionet themelore të këtij koncepti. Sipas GjEDNj-së termi "ligj" përfshin legjislacionin që parashikon krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore dhe çdo dispozitë tjetër në ligjin e brendshëm, ndërsa termi "e krijuar me ligj" përfshin bazën ligjore për vetë ekzistencën e një gjykate. Ky nocion përfshin gjithashtu procesin e emërimit të gjyqtarëve brenda sistemit gjyqësor vendas i cili, në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, duhet të kryhet në përputhje me rregullat e zbatueshme të legjislacionit vendas në fuqi në kohën përkatëse⁹⁴.

Kompetenca është një kusht procedural i vlefshmërisë së procesit gjyqësor dhe i akteve të realizuara gjatë tij në kuptimin që "Një gjykatë jokompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale"⁹⁵. Çështja e kompetencës vlerësohet e lidhur me standardin kushtetues të "gjykatës së krijuar me ligj", element ky i procesit të rregullt ligjor dhe i parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së. Shprehja "gjykatë ... e caktuar me ligj" në nenin 42/2 të Kushtetutës, mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete⁹⁶. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas së cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit⁹⁷. Kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion, të parashikuara nga rendi juridik si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar⁹⁸. Mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm dhe pretendimi për respektimin e kësaj kompetence mund të ngrihet në çdo fazë të procesit. Gjykimi i një çështjeje në kompetencën lëndore të një gjykate tjetër përbën "një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNj-së"⁹⁹.

Kompetenca, ashtu si juridiksioni, përcaktohet në momentin e ngritjes së padisë mbi bazën e

94. Vendim i GjEDNj-së Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë, datë 25/06/2013.

95. Vendim nr. 266/2010 i GjL-së.

96. Vendim nr.41/2005 i GjK-së. Vendim nr.14/2007 i GjK-së. Vendim nr.11/2009 i GjK-së.

97. Vendim nr. 27/2013 i GjK-së. Vendim nr. 22/2009 i GjK-së. Vendim nr. 31/2005 i GjK-së.

98. Vendim nr. 11/2009 i GjK-së. Vendim nr. 44/2014 i GjK-së.

99. Vendim Unifikues i GjL-së nr. 3/2014.

gjendjes faktike që ekziston në momentin e ngritjes së saj. Në gjykimin civil, për përcaktimin e kompetencës tokësore për gjykimin e çështjes, gjykata mban parasysh se cili është ligji i zbatueshëm mbi natyrën e padisë, shkakun ligjor dhe objektin e saj, si edhe cilat janë rrethanat e çështjes që lidhen me përcaktimin e kompetencës sipas atij ligji të zbatueshëm në momentin e pranimit të padisë për shqyrtim.

Nuk kanë asnjë rëndësi ndryshimet e mëvonshme që mund të ndodhin gjatë procesit, të cilat mund të bëjnë që gjykatës t'i mungojë kompetenca¹⁰⁰. Parimi procedural civil “perpetuatio competentiae”, përcakton se çështja që është duke u gjykuar nga një gjykatë kompetente do të vazhdojë të gjykohet prej saj, pavarësisht ndryshimeve apo shtesave dhe/ose pakësimit të objektit të padisë ose ndryshimeve të personave të thirrur si palë e paditur që mund të bëhen gjatë gjyimit, përveç kur ligji parashikon ndryshe.¹⁰¹ Gjithashtu, ndryshimi i një rrethane të tillë të çështjes, sikurse është selia e palës, nuk duhet të sjellë edhe ndryshimin e kompetencës tokësore për gjykimin e çështjes. Ligji procedural parashikon rregullat e përcaktimit të kompetencës tokësore dhe i lidh ato me momentin e fillimit të gjyimit të çështjes. Për shembull, gjykata nuk “ndjek” palët ndërgjyqëse sa herë që ato, për motive nga më të ndryshmet, ndryshojnë vendbanimin apo selinë e tyre¹⁰².

Kompetenca lëndore (*competentia ratione materiae*)¹⁰³ përfshin rrethin e mosmarrëveshjeve civile dhe mosmarrëveshjeve të tjera (për shkak të llojit, natyrës dhe objektit) të parashikuara në K.Pr.C. e në ligje të tjera që i takon të zgjidhë çdo gjykatë si hallkë e sistemit gjyqësor. Kompetenca në sistemin tonë gjyqësor përbën të drejtën dhe detyrën që ka çdo gjykatë për të zgjidhur, gjithnjë duke zbatuar ligjin, vetëm ato çështje që i përkasin juridiksionit gjyqësor të përgjithshëm e që i janë caktuar me ligj. Në këtë kuptim mund të thuhet se kompetenca është *sasia e juridiksionit* ose *masa e juridiksionit*, që çdo gjykatë i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj¹⁰⁴.

Kompetenca tokësore përfshin hapësirën juridiksionale të një territori të përcaktuar nga ligji si dhe brenda një njësie administrative të caktuar. Pra, elementi përcaktues për të dalluar këtë lloj kompetence nga të tjerat, janë kufijtë territorialë dhe juridiksionalë, brenda të cilëve kryhet veprimtaria.¹⁰⁵ Të ndara në kategori, kompetenca tokësore e gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që i vijnë për shqyrtim është e tillë:

- i) kompetencë e përgjithshme (vendbanimi i të paditurit),
- ii) kompetencë e veçantë (vendndodhja e sendit etj.),
- iii) kompetencë alternative;
- iv) kompetencë kontraktuale;
- v) kompetencë për shkak lidhjeje apo koneksiteti¹⁰⁶.

100. Vendim nr. 25/2011 i GjL-së.

101. Vendim nr. 141/2011 i GjL-së.

102. Vendim nr. 8/2013 i GjL-së.

103. Vendim Unifikues i GjL-së nr. 4/2013.

104. Vendim nr. 435/2010 i GjL-së.

105. E drejta administrative 2 - Sokol Sadushi, 2005, shtëpia botuese “ORA”.

106. Vendim nr. 380/2012 i GjL-së. Vendim nr. 119/2013 i GjL-së.

Në analizë të normave procedurale të cilat flasin për kompetencën tokësore, norma këto të parashikuara shprehimisht në Kreun III, Kompetenca, të K.Pr.C., konstatojmë se ligjvënësi për çdo mosmarrëveshje të mundshme civile, apo mosmarrëveshje të tjera të parashikuara në ligje të veçanta, ka përcaktuar së paku një gjykatë kompetente për gjykimin e tyre. Themi së paku një gjykatë kompetente pasi mund të ndodhë që të ketë më tepër se një gjykatë kompetente për të gjykuar një mosmarrëveshje civile, apo mosmarrëveshje të tjera të parashikuara në ligje të veçanta. Në këtë rast, pra kur kemi më shumë se një gjykatë kompetente për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, kemi të bëjmë me kompetenca konkurruese¹⁰⁷.

2. Juridiksioni i gjykatës në gjykimin civil dhe administrativ

Termi “*juridiksion*” (sipas nënndarjes së veprimtarive shtetërore) shpreh pushtetet shtetërore, në mënyrë specifike pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pra, juridiksioni përdoret për të përcaktuar rrethin e çështjeve që në bazë të ligjit kanë të drejtë të zgjidhin organet e një sistemi. Juridiksioni gjyqësor civil është parashikuar në nenin 36 të K.Pr.C., sipas të cilit ai është një juridiksion gjyqësor i përgjithshëm dhe i detyrueshëm (neni 1§2 i K.Pr.C.). Në juridiksionin gjyqësor të përgjithshëm përfshihen shqyrtimi i të gjitha çështjeve që nuk janë shprehimisht të përjashtuara prej tij, që referuar pikës 2 të nenit 42 të Kushtetutës kanë të bëjnë me mbrojtjen e çdo të drejte, lirie dhe çdo interesi kushtetues dhe ligjor¹⁰⁸. Juridiksioni përcaktohet në momentin e ngritjes së kërkesë padisë, mbi bazë të gjendjes faktike që ekziston në momentin e ngritjes së saj¹⁰⁹ dhe ndryshimet e mëvonshme që lidhen me gjendjen e ligjit apo të faktit janë të parëndësishme (*perpetuatio iurisdictionis*)¹¹⁰.

Përpara gjykatës e cila merr në shqyrtim çështjen e juridiksionit shtrohet detyrë që në momentin që ajo vendos të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor të argumentojë në vendimin e saj:

- (i) se përse kjo çështje nuk është në juridiksionin gjyqësor,
- (ii) cila dispozitë ligjore apo cili ligj i veçantë e ka përjashtuar shqyrtimin e kësaj çështjeje nga juridiksioni gjyqësor civil,
- (iii) në cilin juridiksionin bën pjesë çështja që po shqyrtohet dhe cili është organi që duhet të shqyrtojë kërkesën e paraqitur nga kërkuesi ose palët në proces¹¹¹.

Pushteti gjyqësor ushtrohet nga¹¹²:

1. Gjykatat e Shkallës së Parë
2. Gjykatat e Apelit
3. Gjykata e Lartë

107. Vendim nr. 266/2010 i GjL-së.

108. Vendim nr. 435/2010i GjL-së.

109. Vendim nr. 71/2011 i GjL-së.

110. Diritto processuale civile. Manuale breve. Tutto il programma d'esame con domande e risposte commentate, Dario Gramaglia, 2011, Giuffrè Editore, faqe8, Vendim nr. 331/2013 i GjL-së.

111. Vendim nr. 119/2011i GjL-së.

112. Neni 3 i ligjit Nr. 9877, datë 18.2.2008.

Mosrespektimi i dispozitave të lidhura me juridiksionin në gjykimin e mosmarrëveshjes nga gjykata është një nga shkeljet e rënda procedurale të cilat përbëjnë shkak për prishjen e vendimit dhe dërgimit të çështjes për rigjykim. Në nenin 467 të K.Pr.C., është parashikuar se *“Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe dërgon çështjen për rigjykim kur: a) gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën”*.

Në rastin e investimit të të dy juridiksioneve, atij administrativ dhe gjyqësor, ky investim për shqyrtimin e ankimit mbi mosmarrëveshjen administrative, jo vetëm nuk është dhe nuk mund të jetë i njëkohshëm, por as edhe në diskrecionin e organit administrativ apo të individëve e subjekteve ankimuese, për të zgjedhur njërën prej këtyre juridiksioneve. Kështu që vetëm ligji, në mënyrë të shprehur, mund të përcaktojë si rrugë të detyrueshme ndjekjen dhe ezaurimin e rrugës administrative të ankimit nëpërmjet apelimit administrativ, përpara se individ i a subjekti juridik t’i drejtohet gjykatës me anë të padisë përkatëse. Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t’i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ.

Ushtrimi i ankimit administrativ nëpërmjet kërkesës joformale, nuk përbën një rrugë administrative të detyrueshme të subjektit për t’u ankuar, por një të drejtë të tij për ta paraqitur atë kërkesë, duke pasur parasysh se organi administrativ që i kërkohet të shqyrtojë këtë lloj ankimi, mund ta zgjidhë atë vetëm nëse një kompetencë të tillë ia ka njohur shprehimisht ligji. Në rastet e kërkesës joformale, duke mbetur një opsion, një mundësi që ligji i njeh individit për t’i paraqitur organit administrativ pretendimin e tij, gjykata nuk ka pengesë të investohet direkt për ta marrë atë në shqyrtim.

Ndërsa apelimi i detyrueshëm administrativ i njohur dhe i përcaktuar shprehimisht në ligj, si një mjet juridik i plotë për të kërkuar shfuqizimin ose ndryshimin e aktit administrativ, përbën një mjet ankimi me natyrë shteruese, dhe njëkohësisht të detyrueshme për t’u ezauruar me qëllim që më pas t’i drejtohesh gjykatës. Apelimi administrativ kërkon respektimin e disa kushteve formale, pa të cilat nuk mund të pretendohet të kryhet një proces i rregullt administrativ. Kushte formale janë ato të parashikuara nga K.Pr.A., si dhe nga ligjet e veçanta. Ndërkohë që e drejta dhe detyrimi i subjektit për të paraqitur apelim administrativ, si dhe e drejta dhe detyrimi i organit konkret administrativ për ta marrë atë në shqyrtim, si formë ankimi administrativ me efekt shterues, duhet të jenë parashikuar konkretisht dhe shprehimisht në ligjet e posaçme që rregullojnë fushat e veçanta të veprimtarisë administrative¹¹³.

113. Vendim Unifikues i GjL-së nr. 1/2010.

3. Përbërja e rregullt e trupit gjykues

Përbërja e rregullt e trupit gjykues është një ndër komponentët kryesorë të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë në përputhje me ligjin. Ky parim përcakton se gjyqtari "natyral" për të zgjidhur çështjen konkrete, është ai që identifikohet pasi është hedhur shorti dhe çdo procedurë e ndryshme ligjore jo vetëm do t'i binte ndesh ligjit, por do të ishte njëkohësisht në kundërshtim me standardin e sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese europiane, ndër vite, kanë adoptuar disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi të gjykohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Në këtë linjë është vlerësuar edhe nevoja e domosdoshme për caktimin e gjyqtarit me short për shqyrtimin e një çështjeje para se të bëhen publike rrethanat e çështjes dhe palët në gjykim. Gjykata vëren se parimet e përcaktuara në nenin 42 të Kushtetutës nuk mund t'i referohen vetëm organit gjyqësor kompetent, në lëndë dhe territor, për të gjykuar një çështje të caktuar, por i referohen edhe gjyqtarit ose trupës gjykuese, e cila investohet me zgjidhjen e çështjes konkrete. Në këtë kuptim, një procedurë jokorrekte në përcaktimin e gjyqtarit ose trupës gjyqësore nuk është në përputhje me Kushtetutën.¹¹⁴ Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe GjEDNj-ja, e cila në një rast analog, ku kërkuesi pretendonte se i ishte cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, për arsye se gjyqtarët ishin caktuar pa short¹¹⁵.

Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga 1 dhe 3 gjyqtarë, ndërsa GjL gjykon në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 3 dhe 5 gjyqtarë dhe në kolegje të bashkuara me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve.¹¹⁶

Në çështjet penale, gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykojnë me 1 dhe 3 gjyqtarë.¹¹⁷ Gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga 1 dhe 3 gjyqtarë.¹¹⁸ GjL gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 dhe 5 gjyqtarë dhe në kolegje të bashkuara me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve.¹¹⁹

114. Për më gjerë shih modulën "Gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme".

115. Vendim i GjK-së nr. 31/2011.

116. Neni 35 i K.Pr.C.

117. Neni 13 i K.Pr.P.

118. Neni 14 i K.Pr.P.

119. Neni 14/a i K.Pr.P.

5. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A ishte themeluar gjykata që shqyrtonte mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin?	
A kishte gjykata juridiksion për të gjykuar mosmarrëveshjen?	
A kishte gjykata kompetencën lëndore dhe tokësore për të gjykuar mosmarrëveshjen?	
A ishin emëruar gjyqtarët në përbërje të trupit gjykues në përputhje me ligjin?	
A i respektoi gjykata parashikimet ligjore për caktimin e trupit gjykues?	
A i respektoi gjykata parashikimet ligjore për përbërjen e trupit gjykues? (U gjykua mosmarrëveshja nga numri i duhur i gjyqtarëve?)	
A ishin të gjithë gjyqtarët vazhdimisht të pranishëm gjatë gjithë procesit?	
A ishin të gjithë gjyqtarët vazhdimisht të vëmendshëm gjatë gjithë procesit?	
Në rastin se janë themeluar gjykata të veçanta për të mitur dhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, a janë shqyrtuar mosmarrëveshjet nga këto gjykata?	
Në rast se gjyqtari ka pasur një mandat të caktuar për ushtrimin e funksionit, a ka qenë trupi gjykues brenda afatit të mandatit për të shqyrtuar mosmarrëveshjen?	
A ishte përcaktuar në kërkesëpadi vlera e padisë?	

Metodat e matjes

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

MODULI 4

GJYKIMI NGA NJË GJYKATË E PAVARUR DHE E PAANSHME

1. Gjykimi nga një gjykatë e pavarur

Në vështrim të nenit 7 të Kushtetutës pushteti ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe të balancuar midis tyre. Ndonëse renditen njëri pas tjetrit, tri pushtetet e përmendura nuk qëndrojnë në varësi hierarkike nga njëri-tjetri dhe as nuk dominojnë apo i nënshtrohen ndikimeve reciproke ekstra-ligjore¹²⁰.

Në nenin 145/1 të Kushtetutës parashikohet se: “*Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve*”. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat, ndërsa japin drejtësi, t’u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve¹²¹. Gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për funksionin e dhënies së drejtësisë. Asnjë institucion tjetër shtetëror apo zyrtar publik, përveç gjykatave të pavarura, nuk mund ta ushtrojë këtë funksion. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve¹²².

Pavarësia e gjyqësorit kuptohet si:

- ***pavarësi substanciale***, që do të thotë liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit;
- ***pavarësi strukturale*** që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij;
- ***pavarësi organizative*** që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave;
- ***pavarësi financiare*** që nënkupton autonomi në hartimin e buxhetit nga vetë institucioni dhe miratimin nga legjislativi, si një zë i veçantë i buxhetit të shtetit, fonde të përshtatshme e të mjaftueshme për të realizuar qëllimin dhe detyrat e institucionit e sovranitet në lidhje me administrimin e fondeve të akorduara; si dhe

120. Vendim nr. 11/2010 i GjK-së. Vendim nr. 19/2007 i GjK-së.

121. Vendim nr. 19/2007 i GjK-së.

122. Vendim nr. 11/2010 i GjK-së. Vendim nr. 11/2008 i GjK-së.

- **pavarësi personale**, që kërkon emërim në bazë të kritereve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor¹²³.

Në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor duhet të jetë edhe statusi ligjor i gjyqtarëve. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, pa vendim të motivuar të KLGj-së si dhe me garancitë financiare. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre¹²⁴.

2. Gjykimi nga një gjykatë e paanshme

Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor apo të procesit të drejtë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së, është edhe ai i paanshmërisë së gjykatës në gjykimin e çështjes. Në këtë kuadër, parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv* me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të mbajë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv.¹²⁵ Një gjyqtar prezumohet i lirë nga çdo anshmëri dhe e kalon barrën e provës në këtë rast te kundërshtuesi i prezumimit dhe, se çdo gjyqtar është i paanshëm, deri sa të provohet e kundërta. Lidhur me paanshmërinë objektive, GjEDNj-ja është shprehur në shumë raste se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete, nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor.¹²⁶

i. Paanshmëria objektive

Në kuadrin e testit objektiv ajo që analizohet është që pavarësisht nga qëndrimi personal i një gjyqtari, ekzistojnë fakte që hedhin dyshime mbi paanshmërinë e tij. Çështja është pra nëse frika ose dyshimi i një kërkuesi që një gjyqtar nuk është i paanshëm mund të justifikohet apo jo objektivisht.¹²⁷ Ky test përdoret më shumë jo vetëm sepse është më i lehtë për t'u identifikuar, por edhe për t'u provuar në raport me testin subjektiv.¹²⁸

Në kuadrin e testit objektiv mund të merren në shqyrtim lidhjet hierarkike apo të tjera ndërmjet gjyqtarit dhe aktorëve të tjerë në procedurë ose personave të interesuar për

123. Vendim nr. 11/2010 i GJK-së. Vendim nr. 5/2012 i GJK-së.

124. Vendim nr. 26/2009i GJK-së. Vendim nr. 11/2008 i GJK-së. Vendim nr. 11/2004 i GJK-së.

125. Vendim nr. 12/2007i GJK-së. Vendim nr. 4/2009 i GJK. Vendim nr. 15/2012 i GJK-së.

126. Vendim nr. 11/2008 i GJK-së; Vendim i GjEDNj-së Hausschildt kundër Danimarkës datë 24/05/1989; Vendim i GjEDNj-së Fey kundër Austrisë, datë 24/02/1993. Vendim i GjEDNj-së Gautrin et al kundër Francës, datë 20/05/1998.

127. Vendim i GjEDNj-së, Buscemi k. Italisë, datë 16/09/1999.

128. Vendim i GjEDNj-së, Pullar k. Mbretërisë së Bashkuar, datë 10/06/1996.

procedurën. Sidoqoftë, nëse këto kushte janë përmbushur apo jo varet nga rrethanat e secilit rast konkret dhe shpeshherë një analizë tërësore e rrethanave është vendimtarja.¹²⁹

GjK, sa i takon paanshmërisë objektive është shprehur në vendimet e saj se testi objektiv kërkon që të përcaktohet nëse pavarësisht sjelljes personale të gjyqtarit, ka fakte të vërtetueshme, të cilat mund të ngrenë dyshime lidhur me paanshmërinë e tij. Në këtë drejtim edhe dukja mund të ketë një farë rëndësie. Ajo që është e rëndësishme është besimi që publiku dhe mbi të gjitha i akuzuari, duhet të kenë te gjykatat në një shoqëri demokratike. Kjo nënkupton që në vendimmarrje, nëse ka një arsye legjitime që një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i të akuzuarit është i rëndësishëm, por nuk është vendimtar. Ajo që është vendimtare është nëse ky këndvështrim mund të konsiderohet se është objektivisht i justifikueshëm¹³⁰.

Në çështjen Gjon Boçari kundër Shqipërisë, GjEDNj ka arsyetuar ndërmjet të tjerash se: “Lidhur me paanshmërinë objektive, gjykata tashmë ka konkluduar se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen, nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel. Së fundmi, as shqyrtimi paraprak i një informacioni të disponueshëm nuk do të thotë që paragjykohet shqyrtimi përfundimtar¹³¹.

Gjykata e ka bërë të qartë që cilido gjyqtar në lidhje me të cilin ekziston një arsye legjitime për të pasur frikë se i mungon paanshmëria duhet të tërhiqet¹³².

ii. Paanshmëria subjektive

Në kuadrin e testit subjektiv, thelbi është që çdo gjyqtar duhet ta shqyrtojë dhe vendosë një çështje të caktuar që i paraqitet pa asnjë paragjykim. Gjykata kërkon prova të anshmërisë aktuale. Paanshmëria personale e një gjyqtari të duhur të emëruar prezumohet derisa të ketë prova për të kundërtën¹³³. Ky është një prezumim shumë i fortë dhe në praktikë është mjaft e vështirë që të provohet anshmëria personale. Asnjë pretendim i tillë nuk ka qenë i suksesshëm në Strasburg¹³⁴.

Vështirësia qëndron gjithashtu në faktin se, për shkak të vetë funksionit të tij një gjyqtar prezumohet të jetë subjektivisht i paanshëm. Megjithatë ky prezumim është i kundërshtueshëm¹³⁵, por vetëm kur arrihet të tregohet me prova bindëse dhe jo thjesht indicie.

129. Vendim i GjEDNj-së, Mitrov k. Ish Republikës Jugosllave e Maqedonisë.

130. Vendim nr. 374/2021 i GjL-së.

131. Vendim i GjEDNj-së, Gjon Bocari k. Shqipërisë, date 31/03/2005.

132. Vendim i GjEDNj-së, Piersack kundër Belgjikës.

133. Vendim i GjEDNj-së, Hauschildt kundër Danimarkës.

134. Catharina Harby, “E drejta për një proces të drejtë gjyqësor”, Manuallet e të drejtave të njeriut nr.3, fq. 29.

135. Vendim i GjEDNj-së, Fey kundër Austri.

Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë. Jurisprudenca ka konkluduar se gjithashtu se, ky parim kërkon që *drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet*¹³⁶.

Përveç se e paanshme, gjykata duhet të jetë dhe e pavarur. Për të vlerësuar nëse një organ mund të konsiderohet “i pavarur”, duhet të shqyrtohet, *inter alia*, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tij dhe kohëzgjatja e mandatit, ekzistenca e garancive ndaj presioneve të jashtme dhe nëse organi paraqitet si i pavarur¹³⁷.

Për sa u përket standardeve të caktuara nga GjEDNj-ja, në çështjen Piersack kundër Belgjikës, Gjykata u shpreh se: “Ndërsa normalisht paanshmëria nënkupton mungesën e paragjytimeve ose anshmërisë, ekzistenca e saj ose mosekzistenca në mënyrë të dukshme në bazë të Nenit 6 (1) të KEDNj-së do të testohet në mënyra të ndryshme. Në këtë kontekst mund të bëhet një dallim midis një mënyre subjektive që përbën përpjekjen për të siguruar dënimin personal të një gjyqtari të caktuar në një çështje të caktuar, dhe një mënyrë objektive që nënkupton përcaktimin nëse ai ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar ndonjë dyshim legjitim në këtë kuadër”¹³⁸.

3. Caktimi i trupit gjykues nëpërmjet procedurës së shortit

K.Pr.C. dhe K.Pr.P. me qëllim garantimin e një gjykimi të paanshëm, të besueshëm dhe transparent për palët ndërgjyqëse në veçanti, por edhe për publikun në përgjithësi, ka përcaktuar që padia ose kërkesa për gjykim iu caktohet gjyqtarëve me short.

Caktimi i gjyqtarit nëpërmjet shortit lidhet me parimin e një gjykate të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, si një element thelbësor për një proces të drejtë dhe të rregullt ligjor, i cili mënjanon paragjykimin e çështjes, rrit besimin e shtetasve të sistemi i drejtësisë dhe transparencën e këtij të fundit. Në traditën e të drejtës kushtetuese europiane caktimi i gjyqtarit me short në kuadrin e të ashtuquajturit “gjyqtari natyral”, është zhvilluar si standard në lidhje të ngushtë dhe në respekt të parimeve që janë të shprehura në mënyrë eksplicite edhe në nenin 42/2 të Kushtetutës.

Caktimi i gjyqtarit pa short, jashtë kriterëve të përcaktuara rigorozisht në ligj, në kuptim të respektimit të parimit kushtetues të një gjykate të caktuar me ligj, ngre probleme serioze kushtetutshmërie. Duke pasur parasysh se besimi i qytetarëve të sistemi i drejtësisë është një nga elementet thelbësore të mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës, është e domosdoshme që gjykata të jetë dhe të shfaqet e paanshme në sytë e publikut të gjerë.

Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese europiane, ndër vite, kanë adoptuar disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi të gjykohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë

136. Vendim nr. 12/2007 i GJK-së. Vendim nr. 4/2009i GJK-së. Vendim nr. 15/2012 i GJK-së.

137. Vendim i GjEDNj-së, Langborger kundër Suedisë, datë 22/06/1989.

138. Vendim i GjEDNj-së Piersack kundër Belgjikës, datë 01/10/1982.

kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete. Në këtë linjë është vlerësuar edhe nevoja e domosdoshme për caktimin e gjyqtarit me short për shqyrtimin e një çështjeje para se të bëhen publike rrethanat e çështjes dhe palët në gjykim. Vende të ndryshme përdorin metoda të ndryshme të hedhjes së shortit.

Gjykata vëren se parimet e përcaktuara në nenin 42 të Kushtetutës nuk mund t'i referohen vetëm organit gjyqësor kompetent, në lëndë dhe territor, për të gjykuar një çështje të caktuar, por i referohen edhe gjyqtarit ose trupës gjyqësore, e cila investohet me zgjidhjen e çështjes konkrete. Në këtë kuptim, një procedurë jokorrekte në përcaktimin e gjyqtarit ose trupës gjyqësore nuk është në përputhje me Kushtetutën.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe GjEDNj-ja, e cila në një rast analog, ku kërkuesi pretendonte se i ishte cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, për arsye se gjyqtarët ishin caktuar pa short¹³⁹.

GjEDNj-ja konstatonte në rastin e sipërpërmendur se: "gjithsesi, veçmas dështimit të dukshëm për të respektuar detyrimet që burojnë nga Ligji për Gjyqtarët Popullorë (Lay Judges), Gjykata është veçanërisht e shtangur (struck) nga fakti se Autoriteti i Distriktit të Neklinovski-it (organi përgjegjës për caktimin e gjyqtarëve popullorë) ka konfirmuar se nuk kishte lista të gjyqtarëve popullorë, të caktuar para datës 4 shkurt të vitit 2000. Në këtë mënyrë autoritetet dështuan të paraqesin ndonjë bazë ligjore për pjesëmarrjen e znj. Streblyanskaya dhe znj. Khovyakova në administrimin e drejtësisë në ditën e gjykimit të kërkuesit"¹⁴⁰.

Për sa më sipër, përfundimi që nxirret është se autoritetet shtetërore duhet jo vetëm të respektojnë kërkesat ligjore për hedhjen e shortit, por njëkohësisht duhet të dokumentojnë kryerjen e një procedure të tillë nga personat përgjegjës¹⁴¹.

Gjyqtari, i cili është caktuar me short për gjykimin e mosmarrëveshjes mund të ndodhet përpara një konflikti interesi me objektin dhe me palët ndërgjyqëse dhe për rrjedhojë legjislacioni ka parashkruar disa pengesa për gjykimin e mosmarrëveshjes. Në rast se gjyqtari ndodhet përpara këtyre rasteve ai është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i çështjes që i është paraqitur për gjykim ose palët mund të kërkojnë përjashtimin e tij.

4. Shkaqet e heqjes dorë dhe përjashtimit të gjyqtarit në çështjet civile, administrative dhe penale

Rastet kur gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje civile dhe administrative ose kur palët mund të kërkojnë përjashtimin e tij janë kur:

139. Vendim nr. 31/2011 i GjK-së.

140. Vendim i GjEDNj-së, Posokhov kundër Rusisë.

141. Vendim nr. 31/2011 i GjK-së.

1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim;
2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët ose nga mbrojtësit;
3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërën prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve;
4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërës apo tjetrës palë;
5. është kujdestar, punëdhënës i njërës prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim;
6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

Rastet kur gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje penale ose kur palët mund të kërkojnë përjashtimin e tij janë kur:

- a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditori tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij;
- b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërës nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërës prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij;
- c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit;
- ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërën prej palëve private;
- d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale;
- dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim;
- e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në procedim ose për arsye lidhjeje familjare, gjinie ose krushqie.
- ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

5. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A është caktuar gjyqtari nëpërmjet zbatimit të procedurës së shortit?	
A është zhvilluar dhe dokumentuar në përputhje me ligjin nga personat përgjegjës kryerja e procedurës së shortit?	
A kishte gjyqtari interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim?	
A kishte gjyqtari ose familjarë të tij marrëdhënie familjare me njërën nga palët ose nga mbrojtësit?	
A kishte gjyqtari ose familjarë të tij konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërën prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve?	
A kishte dhënë gjyqtari këshilla ose kishte shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo kishte marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëjës apo tjetrës palë?	
A ishte gjyqtari kujdestar, punëdhënës i njëjës prej palëve, administrator ose kishte një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që kishte interesa për çështjen në gjykim?	
A kishte gjyqtari ndonjë shenjë korrupsioni, frikësimi, ngacmimi apo kërcënimi?	
A ishte siguria personale e gjyqtarëve, e prokurorëve, e avokatëve dhe e familjeve të tyre, viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe siguria e ambienteve të gjykatës, e mbrojtur mjaftueshëm?	
A ishin individë me ndikim politik dhe/ose financiar të pranishëm në sallën e gjyqit dhe/ose ndërvepruan me gjyqtarët?	
A paraqitën dyshime nga publiku, OJF-të, avokatët apo mediat mbi pavarësinë apo paanësinë e gjyqtarëve?	
A kishte ndonjë gjyqtar interes (personal, financiar, politik, etnik apo ideologjik) apo çdo konflikt tjetër të mundshëm interesi në shqyrtimin e mosmarrëveshjes?	
A paraqiti gjyqtari kërkesë për të hequr dorë dhe a është pranuar kërkesa?	
A kemi qenë përpara rasteve për përjashtimin e gjyqtarit dhe a është pranuar kërkesa?	
A është zbatuar drejtë procedura për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve?	

Në rast se gjyqtari ka pasur një mandat të caktuar për ushtrimin e funksionit, a ka qenë trupi gjykues brenda afatit të mandatit për të shqyrtuar mosmarrëveshjen?	
A është zgjatur mandati i gjyqtarit me vendim/ndikimin e pushtetit ekzekutiv në funksion të gjykimit të çështjeve të caktuara?	
A ishte gjykata e pavarur financiarisht?	
A ishte publike lista e ekspertëve nga e cila u caktua eksperti për kryerjen e aktit të ekspertimit?	
A u zbatua një sistem rotacioni në caktimin nga gjykata të ekspertit për kryerjen e aktit të ekspertimit?	

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Përqindje</i>
A ishte e ndikuar gjykata në marrjen e vendimit nga pushteti ekzekutiv?	
A ishte e ndikuar gjykata në marrjen e vendimit për shkak të korrupsionit apo ndonjë ndikimi tjetër të paligjshëm?	
A ishte e ndikuar gjykata në marrjen e vendimit për shkak të interesave me karakter personal, financiar, politik, etnik apo ideologjik?	
A ishte e ndikuar gjykata në marrjen e vendimit për shkak të mungesës së sigurisë personale të anëtarëve?	

Metodat e matjes

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.

MODULI 5

E DREJTA PËR TË PASUR NJË GJYKIM PUBLIK

1. E drejta e publikut për të marrë pjesë në seancat gjyqësore

Seanca e hapur gjyqësore përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Karakteri i hapur i procedimeve para organeve gjyqësore sipas nenit 6/1 të KEDNj-së mbron palët ndërgjyqëse kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike. Publiciteti në ushtrimin e drejtësisë kontribuon në përmbushjen e synimit për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike¹⁴².

Neni 6 i garanton çdokujt të drejtën për një seancë të hapur në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile ose të ndonjë akuze penale të ngritur kundër tij. Më tej, Neni 6 deklaron se shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga i gjithë procesi gjyqësor ose një pjesë e tij në interes të moralit, rendit publik ose sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur kërkohen të mbrohen interesat e të miturve ose të jetës private të palëve, ose në një masë që është rreptësisht e domosdoshme në opinionin e gjykatës në rrethana specifike ku publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë.

Një seancë e hapur përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor. GjEDNj në çështjen Axen kundër Republikës Federale të Gjermanisë theksoi se karakteri i hapur i procedimeve përpara organeve gjyqësore që i referohet Nenit 6 (1) mbron palët ndërgjyqëse kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike; është gjithashtu edhe një nga mjetet me anë të të cilave mund të ruhet konfidenca në gjykata, si të shkallës së ulët edhe të shkallëve të lartë. Duke e bërë të dukshëm ushtrimin e drejtësisë, publiciteti kontribuon në përmbushjen e synimit të Nenit 6 (1), shprehimisht një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike brenda kuptimit të KEDNj-së. E drejta për një seancë të hapur përgjithësisht përfshin të drejtën për seancë verbale nëse nuk ka rrethana përjashtuese¹⁴³.

Në rastin e gjykimeve të mosmarrëveshjeve civile dhe administrative, seancat gjyqësore janë të hapura, përveç kur parashikohet ndryshe¹⁴⁴.

Perjashtimi nga rregulli i mësipërm është parashikuar në nenin 173 të K.Pr.C. i cili përcakton

142. Vendimi GjEDNj-së Axen kundër Republikës Federale të Gjermanisë, datë 08/12/1983. Vendim nr. 17/2005 i GjK-së.

143. Vendim i GjEDNj-së Axen kundër Republikës Federale të Gjermanisë, datë 08/12/1983.

144. Neni 26 i K.Pr.C.

se: “Nuk lejohet qëndrimi në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura i të miturve nën 16-vjeç, përveç kur ata thirren nga gjykata.

Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e organeve të medias dhe publikut gjatë një pjese ose gjatë gjithë zhvillimit të procesit gjyqësor:

- a) në interes të moralit;
- b) të rendit publik;
- c) të ruajtjes së informacionit të klasifikuar ose sigurisë kombëtare;
- ç) kur e kërkojnë interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve dhe pjesëmarrësve në gjyq;
- d) kur përmenden sekrete tregtare ose shpikje industriale, nga publikimi i të cilave mund të cenohen interesa që mbrohen me ligj;
- dh) në masën e çmuar nga gjykata, në rrethana të veçanta, publikimi mund të paragjykojë interesat e drejtësisë. Në çdo rast vendimi përfundimtar i gjykatës shpallet publikisht”.

Në çdo rast vendimi përfundimtar i gjykatës shpallet publikisht.

Kundër vendimit të gjykatës për zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura mund të paraqitet ankim nga palët ndërgjyqëse së bashku me vendimin përfundimtar.

Në rastin e shqyrtimit gjyqësor të akuzave penale, seanca gjyqësore është publike dhe ndalohet prania në seancë e:

- të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe ata që janë në gjendje dehje, intoksikimi ose çrregullimi mendor.
- personave të armatosur, me përjashtim të pjesëtarëve të forcave të ruajtjes së rendit.

Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor ose disa veprime të tij të zhvillohen me dyer të mbyllura kur:

- a) kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror ose mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit, në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga organi kompetent;
- b) kur nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës;
- c) kur është e nevojshme të mbrohet siguria e dëshmitarëve ose e të pandehurve;
- ç) kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve si dëshmitarë.
- d) kur viktimi e përcaktuar në nenin 58/b, të K.Pr.P. kërkon të zhvillohet me dyer të mbyllura.

Shqyrtimi gjyqësor zhvillohet gjithmonë me dyer të mbyllura kur:

a) gjykohen të miturit;

b) gjykohen të pandehur të rritur, të cilët akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë, pavarësisht moshës së viktimës gjatë gjykimit.

Në çdo rast, personat që marrin pjesë në një gjykim me dyer të mbyllura informohen nga gjykata për detyrimin që kanë për të mbajtur konfidencial informacionin e mësuar në seancë¹⁴⁵.

2. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A ishte seanca publike dhe a ishin anëtarët e publikut në gjendje të merrnin pjesë në të?	
A u bë publike koha dhe vendi i seancës?	
Nëse është përjashtuar i gjithë publiku ose një pjesë e tij nga pjesëmarrja në seancë, a u dhanë arsye ligjore të cilat justifikojnë përjashtimin e publikut (p.sh., në interes të moralit, të rendit publik, të ruajtjes së informacionit të klasifikuar ose sigurisë kombëtare, e kërkonin interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve dhe pjesëmarrësve në gjyq, përmenden sekrete tregtare ose shpikje industriale, nga publikimi i të cilave mund të cenoheshin interesa që mbrohen me ligj, publikimi mund të paragjykonte interesat e drejtësisë)?	
A morën pjesë në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura të mitur nën 16vjeç?	
A morën pjesë në seancë persona që ishin në gjendje dehje, intoksikimi ose çrregullimi mendor?	
A morën pjesë në seancë persona të armatosur, me përjashtim të pjesëtarëve të forcave të ruajtjes së rendit?	
A u shpall publikisht vendimi i gjykatës?	
A u kërcënuan ndonjë grup individësh, aktivistësh, reporterësh apo OJF për të parandaluar pjesëmarrjen e tyre në gjyq?	
A i ka informuar trupi gjykues personat që marrin pjesë në një gjykim me dyer të mbyllura për detyrimin që kanë për të mbajtur konfidencial informacionin e mësuar në seancë?	

145. Neni 340 i K.Pr.P.

Metodat e matjes

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykata më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës për të pasur një gjykimi publik.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të së drejtës për të pasur një gjykimi publik.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të së drejtës për të pasur një gjykimi publik.
- Statistikat vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

MODULI 6

MASAT PREVENTIVE PËR MBROJTJEN E PALËVE NË PROCES

1. Sigurimi i padisë

Në gjykimin e mosmarrëveshjeve civile, paditësi mund të kërkojë marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë kur ekziston mundësia e një të drejte, mbrojtja e së cilës po kërkohet ose do të kërkohet në një proces gjyqësor dhe ekziston mundësia që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Masa e sigurimit të padisë mund të vendoset nëse:

- padia mbështetet në prova me shkresë.
- paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Në gjykimin e kërkesës për sigurimin e padisë nuk është e domosdoshme, që të jetë vërtetuar plotësisht *ekzistenca e së drejtës* që është edhe objekti i shqyrtimit gjyqësor dhe që ka lidhje me themelin e çështjes, por vetëm të ekzistojë mundësia e të drejtës që kërkohet të rivendoset.

Për të krijuar bindje në lidhje me mundësinë e ekzistencës të së drejtës që kërkohet të rivendoset, për gjykatën është e mjaftueshme që padia të jetë e mbështetur në prova shkresore, pasi këto të fundit i lejojnë gjykatës që të krijojë një njohje të shpejtë të së drejtës që pretendohet se është shkelur.¹⁴⁶Vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë, gjykata nuk duhet ta mbështesë në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtu shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi, sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim¹⁴⁷.

Rëndësia e paraqitjes së provave shkresore në gjykimin e kërkesës për sigurimin e padisë reflektohet qartë dhe në praktikën gjyqësore shqiptare. Në një çështje gjykata shprehet: “në këtë kontekst vlerësimi gjyqësor i mundësisë së sigurimit të objektit të padisë duhet të mbështetet në analizën e provave shkresore të cilat:

146. Vendim nr. 370/2010 i GjL-së.

147. Vendim Unifikues i GjL-së nr. 10/2004.

- Parashirojnë fakte në lidhje me marrëdhënien juridike objekt konflikti mes palëve.
- Mundësojnë vlerësimin nga gjykata të ekzistencës së rrezikut të pamundësisë apo vështirësisë së ekzekutimit të ardhshëm të të drejtave të paditësit¹⁴⁸.

Gjithashtu gjykatat janë shprehur se gjykata përjashton çmimin dhe cilësimin e fakteve në drejtim të themelit të mosmarrëveshjes së pretenduar në funksion të sigurimit të objektit të padisë, sepse sikurse janë shprehur Kolegjet e Bashkuara të GjL-së, shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në mënyrë të tillë që të shmang çdo lloj perceptimi sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim¹⁴⁹.

Për marrjen e masës së sigurimit të padisë nuk është e domosdoshme plotësimi në mënyrë të menjëhershme dhe të kondicionuar i të dyja kushteve të parashikuara në këtë normë procedurale. Është pikërisht gjykata, ajo e cila në respektim të kësaj norme procedurale, pasi konstaton se plotësohen kushtet themelore për marrjen e kësaj mase (kushtet e përmendura më sipër) vendos nëse është e domosdoshme të vihet edhe garanci pasurore apo jo nga ana e palës paditëse.¹⁵⁰

Në rastin e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, ligji ka parashikuar që paditësi mund t'i kërkojë gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë, në rastet kur ai tregon se gjatë kohës së nevojshme të procesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ. Gjykata vendos masën e sigurimit të padisë nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkakut të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin, nuk cenohet rëndë interesi publik dhe nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë¹⁵¹.

Nga sa më sipër rezulton që në rastin e gjykimit administrativ, është parashikuar një kusht i ri shtesë, i cili është që nuk duhet të cenohet rëndë interesi publik. Interesi publik duhet kuptuar si balancë, raport mes mirëqenies individuale dhe asaj komunitare.¹⁵² Koncepti kushtetues i interesit publik, siç është trajtuar tashmë nga jurisprudenca kushtetuese, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese rastet e interesit publik ose të arsyes publike që të çojnë në kufizimin e një të drejte themelore. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit konkret¹⁵³.

Në gjykimet civile dhe administrative, kërkesa për sigurimin e padisë, për shkak të rrethanave

148. Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”: “Masat e sigurimit të padisë në proceset gjyqësore dhe penale, Silvana Cinari, 2015.

149. Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të GjL-së nr. 10, datë 24.10.2004.

150. Vendim nr. 370/2010 i GjL-së.

151. Neni 28 i ligjit nr. 49/2012.

152. Vendim nr. 52/2020 i Kolegjit Administrativ të GjL-së. Vendim nr. 953/2020 i Kolegjit Administrativ të GjL-së.

153. Vendim nr. 4/2011 i GjK-së. Vendim nr. 10/2008 i GjK-së.

të çështjes, mund të paraqitet edhe para ngritjes së padisë. Në këto raste, gjykata, kur lejon sigurimin e padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se 10 ditë në çështjet administrative dhe 15 ditë në çështjet civile, brenda të cilit duhet të ngrihet padia. Kërkesa për sigurimin e padisë, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët.

Për sa u përket llojeve të masave të sigurimit të padisë në mosmarrëveshjet civile, neni 206 i K.Pr.C. parashikon se sigurimi i padisë bëhet:

- a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit;
- b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata.

Gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë.

Në gjykimet administrative, sigurimi i padisë bëhet nëpërmjet:

- a) pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ;
- b) marrjes edhe të masave të tjera të përshtatshme, nga gjykata, në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme.

2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë

K.Pr.C. ka parashikuar edhe mundësinë e pezullimit të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga GjL-ja kur:

- ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose
- pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.

Neni 479/1 i K.Pr.C. garanton vendosjen e masës së përkohshme procedurale të pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë (në kuptimin material) në funksion të zgjidhjes së rekursit, që është ushtruar ndaj vetë vendimit të formës së prerë, duke pasur parasysh arsyet justifikuese të zbatimit të kësaj mase, sikur mundet të jetë dëmi i rëndë dhe i pariparueshëm që mund të sjellë ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kjo e drejtë e palës ndërgjyqëse gjyqëmbëse është paraparë nga ligji procedural civil si mjet që garanton ankimin efektiv në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 13 të KEDNj-së. Kjo do të thotë se pala ndërgjyqëse gjyqëmbëse që bën kërkesën për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë ka barrën t'i paraqesë GjL-së rrethanat konkrete, të bazuara në prova në cilat nga ekzekutimi i menjëhershëm i

vendimit gjyqësor të formës së prerë, kësaj pale mund t'i vijë një dëm i rëndë në mënyrë të parikthyeshme.

Nga ana tjetër, masa e përkohshme e pezullimit zbatohet vetëm ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë që janë tituj ekzekutiv në kuptim të nenit 510/a të K.Pr.C., konkretisht vendimet gjyqësore të formës së prerë që përmbajnë një detyrim (vendimet kondemnatore) dhe nuk zbatohet ndaj vendimeve të njohjes (deklarative), ndaj vendimeve jopërfundimtare të gjykatës apo ndaj vendimeve të gjykatës që marrin formë të prerë vetëm në kuptimin procedural dhe me të cilat nuk zgjidhet çështja në themel. Kjo do të thotë se, vetëm, tek vendimet e detyrimit, debitori gjyqumbës, i cili është ngarkuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me përmbushjen e një detyrimi, ka të drejtë të kërkojë sipas nenit 479 të K.Pr.C. pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi nëse nga ekzekutimi i menjëhershëm atij mund t'i vijë pasoja të rënda dhe të pariparueshme. Qenia titull ekzekutiv e vendimit gjyqësor të formës së prerë, përbën premisën bazë, të cilën Gjykata e Lartë e vlerëson paraprakisht në çdo kërkesë pezullimi. Vetëm pasi plotësohet ky kusht (*conditio sine qua non*), GjL-ja vlerëson më pas, rast pas rasti, nëse ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit sjell apo jo pasoja të rënda dhe të pariparueshme¹⁵⁴.

Masa e përkohshme e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë sipas nenit 479 të K.Pr.C. ka karakter përjashtimor dhe të jashtëzakonshëm. Në të kundërt do të zhvleftësohej fuqia juridike e vendimit gjyqësor të formës së prerë, detyrueshmëria për zbatimin e tij nga palët ndërgjyqëse dhe mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga përjashtim do të shndërrohej në rregull. Kjo do të vinte ndesh me të drejtën kushtetuese dhe konventore të kujtudo për të pasur një proces të rregullt ligjor, e drejtë që përfshin jo vetëm fazën njohëse të së drejtës, por edhe fazën ekzekutive. Kjo do të thotë se pala që e kërkon pezullimin ka barrën e paraqitjes së fakteve dhe argumenteve konkrete se cili është dëmi i rëndë që asaj mund t'i vijë nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe pse apo në çfarë mënyre ky dëm është me natyrë të parikthyeshme. GjL-ja në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të K.Pr.C. për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, do të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjore dhe/ apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.¹⁵⁵ Bazuar në parimin e dhënies drejtësi dhe parimit të proporcionalitetit të masave të përkohshme, GjL-ja mban parasysh një ekuilibër dhe një balancim të të drejtave

154. Vendimi nr. 196/14/2021 i Kolegjit Civil të GjL-së.

155. Vendimi nr. 248/25/2021 Kolegji Civil i GjL-së.

dhe interesave të palëve ndërgjyqëse, duke vlerësuar dëmin që mund t'i vijë palës debitore gjyqumbëse nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë, në raport me dëmin e palës kreditore gjyqfituese nga pezullimi i ekzekutimit të këtij vendimi¹⁵⁶.

3. Sigurimi i provës

Neni 292 i K.Pr.C. parashikon se kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e mosmarrëveshjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërohet marrja më përpara. Kërkesa për sigurimin e provës mund të paraqitet në gjykatën që shqyrton çështjen nëpërmjet paraqitjes së padisë, gjatë gjykimit të çështjes ose në rast se padia nuk është ngritur, në gjykatën e vendit ku ka banim personi që do të pyetet ose ku ndodhet sendi që duhet të këqyret¹⁵⁷.

Sigurimi i provës është një nga ato kërkime që paraqiten si të ngutshme, nëse paraqitet një kërkesë e tillë gjykata duhet t vlerësojë kërkimet e kërkuarit dhe të procedojë me vendimin e ndërmjetëm për sigurimin ose jo të provës. Kërkesa për sigurimin e provës mund të paraqitet para fillimit ose dhe gjatë vazhdimësisë së tij.

Në kërkesën për sigurimin e provës duhet të tregohen:

- prova që do të merret;
- rrethanat për vërtetimin e të cilave shërben ajo;
- arsyet që e justifikojnë marrjen e saj më përpara.

Me qëllim zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, kopja e kërkesës i komunikohet palës tjetër, përveç kur kjo nuk dihet ose kur marrja e provës nuk lejon shtytje.¹⁵⁸ Mosparaqitja e palës që ka kërkuar marrjen e provës sjell rrëzimin e kërkesës, përveç rastit kur e kërkon edhe pala tjetër, ose gjykata kryesisht çmon se është në dobi të gjykimit

Në nenin 295 të K.Pr.C. parashikohet se vendimi me të cilin pranohet kërkesa për sigurimin e provës duhet të tregojë provën që do të merret dhe mënyrën e marrjes së provës. Kundër vendimit të gjykatës me të cilin refuzohet kërkesa për sigurimin e provës, mund të bëhet ankim i veçantë, ndërsa kundër vendimit i cili pranon kërkesën për sigurimin e provës bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.

Nga ana tjetër në nenin 296 parashikohet se “mosparaqitja e palës që ka kërkuar marrjen e provës sjell rrëzimin e kërkesës, përveç kur kërkon pala tjetër ose gjykata çmon se është në dobi të gjykimit”.

Për mënyrën e marrjes së provës dhe për fuqinë e saj provuese zbatohen rregullat e përgjithshme përveç përjashtimeve të parashikuara shprehimisht në K.Pr.C.. Shpenzimet

156. Vendimi nr. 264/29/2021 Kolegji Civil i GjL-së.

157. Neni 293 K.Pr.C.

158. Neni 294 K.Pr.C.

për marrjen provës parapaguhën nga kërkuesi dhe në përfundim të gjykimit i ngarkohen palës sipas rregullave të përgjithshme¹⁵⁹.

Në shqyrtimin e akuzave penale, gjatë hetimeve paraprake, prokurori dhe i pandehuri mund të kërkojnë nga gjykata që të procedohet me sigurimin e provës në këto raste:

- a) në marrjen e dëshmisë së një personi, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ai nuk mund të pyetet në shqyrtimin gjyqësor për shkak sëmundjeje ose pengesë tjetër serioze;
- b) në marrjen e dëshmisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi mund të jetë objekt dhune, kanosje ose premtimi për t'i dhënë para ose përfitime të tjera me qëllim që të mos bëjë dëshmi ose të bëjë dëshmi të gënjeshtërt;
- c) në pyetjen e të pandehurit për faktet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e të tjerëve, kur ekziston një nga rrethanat e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b";
- d) në ballafaqimin ndërmjet personave që para prokurorit kanë bërë deklarime kundërthënëse, kur ekziston një nga rrethanat e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b";
- e) për një ekspertim apo eksperiment gjyqësor, kur prova ka të bëjë me një person, një send anjë vend, gjendja e të cilëve mund të pësojë ndryshime të pashmangshme. Ekspertimi mund të kërkohet edhe kur është rasti që po të bëhet gjatë shqyrtimit gjyqësor do të sillte një pezullim të gjykimit mbi gjashtëdhjetë ditë;
- f) në një paraqitje për njohje, kur për arsye të veçanta nuk mund të shtyhet veprimi deri në shqyrtimin gjyqësor.

Personi viktimë mund t'i drejtohet prokurorit që ai të kërkojë sigurimin e provës. Kur nuk e pranon kërkesën, prokurori merr vendim të arsyetuar dhe njofton personin viktimë, i cili mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit. Ankimi i njoftohet menjëherë prokurorit.

Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi brenda 5 ditëve nga depozitimi i ankimit në sekretarinë e gjykatës. Prokurori, jo më vonë se 2 ditë nga njoftimi i ankimit, mund të paraqesë parashtrime me shkrim lidhur me bazueshmërinë e ankimit dhe të depozitojë prova në mbështetje të tyre.

Viktima akuzuese mund t'i kërkojë gjykatës që të procedojë në sigurimin e provës para fillimit të gjykimit.

Brenda dy ditëve nga ardhja e përgjigjes për marrjen e njoftimit për kërkesën për sigurimin e provës, gjykata merr vendim në dhomë këshillimi, me të cilin pranon ose rrëzon kërkesën për sigurimin e provës.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve. Gjykata e apelit e shqyrton ankesën në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga dorëzimi i akteve në këtë gjykatë.

159. Flutura Kola Tafaj, "Procedurë Civile-Pjesa 1", 2018, fq. 590.

Seanca për marrjen e provës zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit të të pandehurit. Ka të drejtë të marrë pjesë edhe përfaqësuesi i viktimës. I pandehuri dhe viktimja kanë të drejtë të marrin pjesë kur duhet të pyetet një dëshmitar ose një person tjetër. Në rastet e tjera ata mund të marrin pjesë me autorizim paraprak të gjykatës. Provat merren sipas rregullave të caktuara për shqyrtimin gjyqësor, nga e njëjta gjykatë që do të gjykojë çështjen¹⁶⁰.

4. Udhëzim i shkurtër në lidhje me treguesit e realizimit dhe metodat e matjes

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A është shqyrtuar nga gjykata kërkesa për sigurimin e padisë brenda afatit 5-ditor të regjistrimit në gjykatë?	
A e ka shqyrtuar gjykata kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë në prani të palëve dhe a është njoftuar rregullisht pala tjetër për datën dhe orën e seancës për shqyrtimin e kërkesës?	
Nëse kërkesa është shqyrtuar në dhomë këshillimi, a ka qenë gjykata përpara rasteve të veçanta dhe të ngutshme për të shqyrtuar kërkesën pa praninë e palëve?	
A ka vendosur gjykata marrjen e masës së sigurimit për një kërkesë/kërkesëpadi pa palë kundërshtare?	
A i është njoftuar palës tjetër kërkesa për sigurimin e padisë dhe provat e paraqitura në mbështetje të kërkesës përpara seancës dhe duke i dhënë kohë të mjaftueshme për të organizuar mbrojtjen?	
Në rastin kur kërkesa për sigurimin e padisë është shqyrtuar përpara ngritjes së padisë, a kemi qenë përpara rasteve të veçanta dhe të ngutshme për të shqyrtuar kërkesën pa u paraqitur kërkesëpadi?	
A është vendosur një nga masat e sigurimit të padisë të parashikuara në ligj?	
A i është njoftuar palës tjetër nga Gjykata e Lartë kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit përpara se të merret në shqyrtim?	
A është arsyetuar nga Gjykata e Lartë vendimi për kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit?	
A i është njoftuar të gjitha palëve vendimi i GjL-së mbi kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit?	

160. Nenet 316-321 të K.Pr.P.

Metodat e matjes

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykata më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e dispozitave ligjore për zbatimin ose refuzimin e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për zbatimin e nenit 39 të KEDNj-së, në kuadër të zbatimit të masave provizore.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.

RASTE STUDIMORE

Kazus nr. 1

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm, Tiranë është paraqitur nga shtetasi A kërkesëpapia me objekt njohjen me të drejta të plota pronar për pasurinë me nr. 00 zona kadastrale nr. 11, me palë të paditur shtetasin B. Sendi ishte i regjistruar në regjistrin kadastral në bashkëpronësi emër të shtetasit B dhe C.

Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm, Tiranë në përfundim të gjykimit, me vendimin nr.11 datë 01.03.2022 ka vendosur pranimin e padisë si të bazuar në ligj dhe prova.

Kundër vendimit ka paraqitur ankim pala e paditur shtetasi B. Në ankimin e shtetasit B janë paraqitur pretendime vetëm lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit material dhe nuk janë paraqitur pretendime për shkelje të procedurës nga Gjykata e Shkallës së Parë.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë ka kryer njoftimin e palëve nëpërmjet shpalljes publike të datës 01.04.2023 dhe ka caktuar zhvillimin e seancës gjyqësore me prani të palëve në datën 07.04.2023.

Seanca gjyqësore e datës 07.04.2023 është zhvilluar në mungesë të palë ndërgjyqëse. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Pyetje:

1. **A është formuar drejtë ndërgjyqësia?**
2. **A janë kryer shkelje procedurale nga Gjykata e Shkallës së Parë në gjykimin e mosmarrëveshjes? Nëse po, cilat shkelje janë kryer?**
3. **A ka vepruar drejt Gjykata e Apelit kur ka gjykuar çështjen në mungesë të palëve?**
4. **A kishte detyrim Gjykata e Apelit të verifikonte nëse vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është marrë në zbatim të ligjit procedural, pavarësisht që ky pretendim nuk është paraqitur në ankim?**
5. **Çfarë duhet të vendoste Gjykata e Apelit?**

Kazus nr. 2

Pala A ka paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë kërkesëpadinë me objekt: shfuqizimin e aktit administrativ për mbylljen e shkollës së mesme private "X" dhe palë të paditur Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Trupi gjykues vendosi që gjykimi të zhvillohet me dyer të mbyllura me arsyetimin se shkolla private zhvillon një aktivitet, i cili ka interes për publikun duke qenë se ndjekin studimet 200 nxënës. Për rrjedhojë, nuk u pranua kërkesa e disa gazetarëve për të marrë pjesë në seancë dhe për të regjistruar me video seancat.

Për shkak se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ishin të nevojshme njohuri të posaçme, gjykata vendosi zhvillimin e aktit të ekspertimit. Eksperti i caktuar nga gjykata arriti në konkluzionin se shkolla e mesme private "X" nuk plotësonte kushtet higjienike-sanitare. Eksperti arriti në këtë konkluzion në bazë të shqyrtimit prej tij të dokumentacionit higjieniko-sanitar të vendosur në dispozicion nga Inspektorati i Higjienës dhe që nuk ishte administruar si provë në dosje.

Në bazë të përfundimeve të aktit të ekspertimit, gjykata vendosi të rrëzojë kërkesëpadinë.

Pyetje:

1. **A duhet të zhvillohej gjykimi me dyer të mbyllura?**
2. **A kanë mundësi efektive palët ose publiku për të kundërshtuar vendimin për zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura?**
3. **A duhet të lejoheshin gazetarët të merrnin pjesë si dëgjues në seancat gjyqësore?**
4. **A duhet të lejoheshin gazetarët të regjistronin me video seancat gjyqësore?**
5. **A janë kryer nga gjykata të gjitha veprimet procedural për zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm?**
6. **A është respektuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në kushtet kur gjykata ka bazuar vendimin e saj te prova e administruar nëpërmjet aktit të ekspertimit?**

EKSTRAKTE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 42

Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Nenin 145

Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

K.Pr.C.

Neni 2

Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 5

Objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet në pretendimet e palëve.

Pretendimet parashtrohen në aktin për fillimin e procesit gjyqësor, si dhe gjatë ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga ky proces. Objekti i mosmarrëveshjes mund të ndryshojë sipas kërkesave që lindin gjatë procesit, kur këto të fundit kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit.

Neni 6

Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet

Neni 14

Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.

Neni 16

Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

Megjithatë, gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës.

Nenet 18-20

Asnjë palë nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim.

Palët duhet t'i bëjnë të njohur njëra-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore që do t'u referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim.

Gjykata duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit.

Ajo mbështet vendimin e saj vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të treguara ose të sjella nga palët, kur këto të fundit kanë qenë në gjendje të debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit.

Neni 26

Seancat gjyqësore janë të hapura, përveç kur parashikohet ndryshe sipas këtij Kodi.

Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e medias, kur çmon se nuk është në dobi të gjykimit. Në çdo rast vendimi përfundimtar i gjykatës shpallet publikisht.

Neni 173

Nuk lejohet qëndrimi në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura i të miturve nën 16 vjeç, përveç kur ata thirren nga gjykata.

Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e organeve të medias dhe publikut gjatë një pjese ose gjatë gjithë zhvillimit të procesit gjyqësor:

- a) në interes të moralit;
- b) të rendit publik;
- c) të ruajtjes së informacionit të klasifikuar ose sigurisë kombëtare;
- ç) kur e kërkojnë interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve dhe pjesëmarrësve në gjyq;
- d) kur përmenden sekrete tregtare ose shpikje industriale, nga publikimi i të cilave mund të cenohen interesa që mbrohen me ligj;

dh) në masën e çmuar nga gjykata, në rrethana të veçanta, publikimi mund të paragjykojë interesat e drejtësisë.

Vendimi shpallet publikisht.

Neni 202

Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Sigurimi i padisë lejohet kur:

- a) padia mbështetet në prova me shkresë;
- b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni.

Ligj nr. 49/2012

1. Me paraqitjen e padisë, paditësi mund t'i kërkojë gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë, në rastet kur ai tregon se gjatë kohës së nevojshme të procesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ.
2. Kërkesa për sigurimin e padisë, për shkak të rrethanave të çështjes, mund të paraqitet edhe para ngritjes së padisë. Në këto raste, gjykata, kur lejon sigurimin e padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se 10 ditë, brenda të cilit duhet të ngrihet padia.
3. Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në raste të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët.
4. Vendimi për sigurimin e padisë jepet në çdo fazë dhe shkallë të shqyrtimit gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Në të gjitha rastet gjykata duhet të arsyetojë vendimin e saj. Vendimi jepet nga gjykata, pranë së cilës ndodhet padia.

K.Pr.P.

Neni 4

I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.

Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Neni 6

I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat në rastet e parashikuara nga ky Kod.

Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t'i garantohen të drejtat procedurale dhe t'i ruhen interesat e tij ligjore.

Neni 7

Askush nuk mund të gjykohet rishtas për të njëjtin fakt penal, për të cilin është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente

Neni 339

1. Seanca gjyqësore është publike, përndryshe quhet e pavlefshme.
2. Nuk pranohen në seancë të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe ata që janë në gjendje dehje, intoksikimi ose çrregullimi mendor.
3. Ndalohet prania në seancë e personave të armatosur, me përjashtim të pjesëtarëve të forcave të ruajtjes së rendit.

BIBLIOGRAFIA

Ligjet

- Ligji nr. 49/2012 Ligji nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar
- Ligji nr. 111/2017 Ligji nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*
- Ligji nr. 115/2016 Ligji nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*
- Ligji nr. 96/2016 Ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”*.
- Ligji nr. 10385, datë 24.02.2011 Ligji nr. 10385, datë 24.02.2011 *“Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”*

Literaturë

- Dhimitër Lara, *“Koment mbi procedurën penale”*, 2019
- Frowein/Peukert, *Europäische Menschenrechtskonvention-Komentar* (1996) faqe 227.
- Kreshnik Myftari, Sevada Guço, *“Prezumimi i pafajësisë-parim i rëndësishëm kushtetues”*. Revista *“Studime Juridike”* nr. 2, 2013.
- Kristaq Traja, *“Procesi i rregullt ligjor”*, Revista *“Studime Juridike”*, nr. 1, 2005.
- Nicola Picardi, *Manuale del processo civile*, seconda edizione, Giuffrè Editore.
- E drejta administrative 2 – Sokol Sadushi, 2005, shtëpia botuese *“ORA”*.
- Diritto processuale civile. Manuale breve. Tutto il programma d’esame con domande e risposte commentate, Dario Gramaglia, 2011, Giuffrè Editore.
- Catharina Harby, *“E drejta për një proces të drejtë gjyqësor”*.
- Manualet e të drejtave të njeriut nr.3.
- Flutura Kola Tafaj, *“Procedurë Civile-Pjesa 1”*, 2018.

Vendime GJEDNJ

Vendimi i GjEDNj-së Alimena kundër Italisë, datë 19/02/1991.

Vendim i GjEDNj-së Kremzow kundër Austrisë, datë 21/09/1993.

Vendim i GjEDNj-së Alimena kundër Italisë, datë 19/02/1991.

Vendim i GjEDNj-së Minelli kundër Zvicrës, datë 25/03/1983.

Vendim i GjEDNj-së Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 08/02/1966.

Vendim i GjEDNj-së Allenet de Ribemont kundër Francës, datë 10/02/1995.

Vendim i GjEDNj-së Veeber kundër Estonisë, datë 21/01/2003.

Vendim i GjEDNj-së G. Kundër Francës, datë 27/09/1995.

Vendim i GjEDNj-së Dehaes dhe Giples kundër Belgjikës, datë 04/02/1997.

Vendim i GjEDNj-së Dombo Behere kundër Holandës, datë 27/10/1993.

Vendim i GjEDNj-së Stratis Andreadhis kundër Greqisë, datë 09/12/1994.

Vendim i GjEDNj-së Ruiz-Mateos, kundër Spanjës, datë 23/06/1993.

Vendim i GjEDNj-së Vermeulen kundër Belgjikës, datë 20/02/1996.

Vendim i GjEDNj-së Nideröst-Huber kundër Zvicrës, datë 18/02/1997.

Vendim i GjEDNj-së Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë.

Vendim i GjEDNj-së Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë, datë 25/06/2013.

Vendim i GjEDNj-së Hausschildt kundër Danimarkës, datë 24/05/1989;

Vendim i GjEDNj-së Fey kundër Austrisë, datë 24/02/1993.

Vendim i GjEDNj-së Gautrin et al kundër Francës, datë 20/05/1998.

Vendim i GjEDNj-së, Buscemi k. Italisë, datë 16/09/1999.

Vendim i GjEDNj-së, Pullar k. Mbretërisë së Bashkuar, datë 10/06/1996.

Vendim i GjEDNj-së, Mitrov k. ish-Republikës Jugosllave e Maqedonisë

Vendim i GjEDNj-së, Gjon Bocari k. Shqipërisë, datë 31/03/2005.

Vendim i GjEDNj-së, Piersack kundër Belgjikës.

Vendim i GjEDNj-së, Hauschildt kundër Danimarkës.

Vendim i GjEDNj-së, Fey kundër Austri.

Vendim i GjEDNj-së, Langborger kundër Suedisë, datë 22/06/1989.

Vendim i GjEDNj-së Piersack kundër Belgjikës, datë 01/10/1982.

Vendim i GjEDNj-së, Posokhov kundër Rusisë.

Vendimi i GjEDNj-së Axen kundër Republikës Federale të Gjermanisë, datë 08/12/1983.

Jurisprudenca vendase:

Vendimi nr. 19/2003 i GjK-së.

Vendimi nr. 33/2003 i GjK-së.

Vendimi nr. 44/2000 i GjK-së.

Vendimi nr. 25/2003 i GjK-së.

Vendimi nr. 23/2005 i GjK-së.

Vendimi nr. 24/2005 i GjK-së.

Vendimi nr. 7/2007 i GjK-së.

Vendimi nr. 16/2009 i GjK-së.

Vendimi nr. 30/2010 i GjK-së.

Vendimi nr. 45/2011 i GjK-së.

Vendimi nr. 19/2003 i GjK-së.

Vendimi nr. 5/2003 i GjK-së.

Vendimi nr. 33/2003 i GjK-së.

Vendimi nr. 19/2003 i GjK-së.

Vendimi nr. 19/2008 i GjK-së.

Vendimi nr. 40/2011 i GjK-së.

Vendimi nr. 4/2012 i GjK-së.

Vendimi nr. 33/2011 i GjK-së.

Vendimi nr. 5/2005 i GjK-së.

Vendimi nr. 29/2006 i GjK-së.

Vendimi nr. 47/2011 i GjK-së.

Vendimi nr.13/2003 i GjK-së.

Vendimi nr. 15/2008 i GjK-së.

Vendimi nr. 23/2009 i GjK-së.

Vendimi nr. 9/2004 i GjK-së.

Vendimi nr. 47/2011 i GjK-së.

Vendimi nr. 00-2022- 1600/2022 i GjL-së.

Vendimi nr. 14/2007 i GjK-së.

Vendimi nr. 16/2009 i GjK-së.

Vendimi nr. 35/2005 i GjK-së.

Vendimi nr. 14/2007 i GjK-së.
Vendimi nr. 35/2005 i GjK-së.
Vendimi nr. 4/2005 i GjK-së.
Vendimi nr. 5/2006 i GjK-së.
Vendimi nr. 8/2006 i GjK-së.
Vendimi nr. 34/2007 i GjK-së.
Vendimi nr. 109/2002 i GjK-së.
Vendimi nr. 11/2005 i GjK-së.
Vendimi nr. 27/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 190/2010 i GjK-së.
Vendimi nr. 168/2010 i GjL-së.
Vendimi nr. 152/2012 i GjL-së.
Vendimi nr. 19/2003 i GjK-së.
Vendimi nr. 23/2007 i GjK-së.
Vendimi nr. 34/2011 i GjK-së.
Vendimi nr. 18/2013 i GjK-së.
Vendimi nr. 51/2013 i GjK-së.
Vendimi nr. 255/2010 i GjL-së.
Vendimi nr.69/2000 i GjK-së.
Vendimi nr. 19/2005 i GjK-së.
Vendimi nr. 5/2003 i GjK-së.
Vendimi nr. 33/2003 i GjK-së.
Vendimi nr. 16/2006 i GjK-së.
Vendimi nr. 13/2008 i GjK-së.
Vendimi nr. 28/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 30/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 38/2010 i GjK-së.
Vendimi nr. 459/2013 i GjL-së.
Vendimi nr. 18/2010 i GjL-së.
Vendimi nr. 582/2012 i GjL-së.
Vendimi nr. 117/2009 i GjL-së.

Vendimi nr. 331/2009 i GjL-së.
Vendimi nr. 573/2014 i GjL-së.
Vendimi nr. 593/2014 i GjL-së.
Vendimi nr. 24/2008 i GjK-së.
Vendimi nr. 15/2012 i GjK-së.
Vendimi nr. 9/2007 i GjK-së.
Vendimi nr. 24/2008 i GjK-së.
Vendimi nr. 484/2006 i GjL-së.
Vendimi nr. 606/2014 i GjL-së.
Vendimi nr. 18/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 293/2010 i GjL-së.
Vendimi nr. 61/2001 i GjK-së.
Vendimi nr. 366/2013 i GjL-së.
Vendimi nr. 37/2013 i GjL-së.
Vendimi nr. 128/2013 i GjL-së.
Vendimi nr. 31/2005 i GjK-së.
Vendimi nr. 7/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 27/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 18/2007 i GjK-së.
Vendimi nr. 23/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 7/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 31/2005 i GjK-së.
Vendimi nr. 16/2012 i GjK-së.
Vendimi nr. 00-2020-13/2020 i GjL.
Vendimi nr. 266/2010 i GjL.
Vendimi nr. 41/2005 i GjK-së.
Vendimi nr. 14/2007 i GjK-së.
Vendimi nr. 11/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 27/2013 i GjK-së.
Vendimi nr. 22/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 31/2005 i GjK-së.

Vendimi nr. 11/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 44/2014 i GjK-së.
Vendimi nr. 25/2011 i GjL-së.
Vendimi nr. 141/2011 i GjL-së.
Vendimi nr. 8/2013 i GjL-së.
Vendimi nr. 435/2010 i GjL-së.
Vendimi nr. 380/2012 i GjL-së.
Vendimi nr. 119/2013 i GjL-së.
Vendimi nr. 266/2010 i GjL-së.
Vendimi nr. 435/2010 i GjL-së.
Vendimi nr. 71/2011 i GjL-së.
Vendimi nr. 119/2011 i GjL-së.
Vendimi i GjK nr. 31/2011.
Vendimi nr. 11/2010 i GjK-së.
Vendimi nr. 19/2007 i GjK-së.
Vendimi nr. 11/2008 i GjK-së.
Vendimi nr. 5/2012 i GjK-së.
Vendimi nr. 26/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 11/2008 i GjK-së.
Vendimi nr. 11/2004 i GjK-së.
Vendimi nr. 12/2007 i GjK-së.
Vendimi nr. 4/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 15/2012 i GjK-së.
Vendimi nr. 11/2008 i GjK-së.
Vendimi nr. 374/2021 i GjL-së.
Vendimi nr. 12/2007 i GjK-së.
Vendimi nr. 4/2009 i GjK-së.
Vendimi nr. 15/2012 i GjK-së.
Vendimi nr. 31/2011 i GjK-së.
Vendimi nr. 17/2005 i GjK-së.
Vendimi nr. 370/2010 i GjL-së.

Disertacion për mbrojtjen e gragës shkencore “Doktor”：“Masat e sigurimit të padisë në proceset gjyqësore dhe penale, Silvana Cinari, 2015.

Vendim nr. 370/2010 i GjL-së.

Vendim nr. 52/2020 i Kolegjit Administrativ të GjL-së.

Vendim nr. 953/2020 i Kolegjit Administrativ të GjL-së.

Vendim nr. 4/2011 i GjK-së.

Vendim nr. 10/2008 i GjK-së.

Vendimi nr. 196/14/2021 i Kolegji Civil të GjL-së.

Vendimi nr. 248/25/2021 Kolegji Civil i GjL-së.

Vendimi nr. 264/29/2021 Kolegji Civil i GjL-së.

Vendim nr. 331/2013 i GjL-së.

Vendim Unifikues i GjL-së nr. 10/2004.

Vendim Unifikues i GjL-së nr. 3/2014.

Vendim Unifikues i GjL-së nr. 4/2013.

Vendim Unifikues i GjL-së nr. 1/2012.

Vendim Unifikues i GjL-së nr. 1/2010.

Vendim Unifikues i GjL-së nr.3/2012.

Vendimi Unifikues i GjL-së nr. 628/2000.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore

Proçesi i rregullt gjyqësor : manual / Instituti për Studimet
Publike dhe Ligjore. - Tiranë : Muza, 2023.

Pj.1, ... f. ; ... cm

Bibliogr..

ISBN 9789928361455

1.E drejta 2.Gjykimi 3.Manuale

347.91/.95 (035)